



JYKATA FIER

3823

25.6.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2985 Prot.Tiranë, më 24/062021

Lënda: Dërgim projekt raport auditimi

GJYKATËS RRETHIT GJYQËSOR

FIER

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në bazë të planit vjetor të auditimit të miratuar për vitin 2021 dhe programit të angazhim auditimit Nr.Ref.4, datë 14/05/2021, realizoi misionin e auditimit me objekt “Vlerësimin e përputhshmërisë të veprimtarisë të institucionit tuaj me kuadrin rregullator”, për periudhën 01/01/2019 deri më 31/12/2020.

Bazuar në Ligjin Nr.114/2015, datë 22/10/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kreu II-të, neni 5 dhe 6. Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25/10/2016, ndryshuar me Urdhërin Nr.4, datë 10/01/2020, për “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, u hartua projekt raport auditimi për institucionin tuaj.



Në bazë të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kap. IV, pika 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njesia e audituar”, ju dërgojmë dy kopje të projekt raport auditimit. Brënda 10 ditë pune nga marrja e këtij materiali, të kthehet një kopje e projekt raport auditimit të nënshkruar. Mund të bëni shpjegime me shkrim (observacione/kundërshtime) ose mund të kërkonit takim ballafaques me grupin e auditimit në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e sygjera.

Tejkalimi i këtij afati i konsideron të pranuar rekomandimet e paraqitura në projekt raport auditimit dhe dërguar.

Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni dy kopje të projekt raport auditimit dhe Aneksin 1 përmbledhëse rekomandimeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARE
NAUREDA ILIAGAMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**PROJEKT RAPORT AUDITIMI
PËR
GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR FIER**

**Periudha e audituar
(01/01/2019 - 31/12/2020)**

Tiranë, Qershor 2021

PASQYRA E LËNDËS



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. HYRJE

III. METODA E AUDITIMIT

IV. GJETJET, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM



V. ANEKSI 1, PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

I. Përmbledhje ekzekutive

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar në bazë të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, planit vjetor të auditimit, të miratuar për vitin 2021 dhe programit të angazhim auditimit Nr.ref.4, date 14.05.2021, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në KLGJ, ushtroi auditim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për : Zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm; vlerësimin e veprimtarisë ekonomike dhe organizative; marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale; mbikqyrjen e administrimit të riskut dhe kontrolleve; sigurimi i administrimit efektiv të punës organizative dhe pergjegjesise; dhënia e rekomandimeve konstruktive për të ndihmuar gjyktën në përmirësimin e veprimtarisë së saj në arritjen e objektivave.

Për identifikimin e sistemeve, grupi i auditimit u bazua në raportet e mëparshme të auditimit, dispozitat e organizimit dhe funksionimit, strukturën organizative dhe dokumentacionin që disponon gjykata.

Qëllimi i auditimit: Informimi i menaxhimit mbi punën e bërë në gjykatë, raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve, dhënia e opinionëve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhënia e rekomandimeve për të ndihmuar gjykatën në përmirësimin e veprimtarisë së saj në arritjen e objektivave.

Periudha e auditimit: 01/01/2019 deri më 31/12/2020.

Përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore: Gjetjet e trajtuara në projekt raport janë sipas sistemeve/fushave të audituara, duke vlerësuar impaktin/ndikimin dhe rëndësinë e çdo gjetje është lënë dhe rekomandimi përkatës për përmirësim.

Për sistemin organizativ:

- Vazhdon të ngelet problem, pamjaftueshmëria me ambjente për ushtrimin e veprimtarisë normale të gjykates, mungesa e sallave të gjykimit, zyrave për administratën, ambjenteve për arkivimin e dosjeve gjyqësore dhe magazinimin e materialeve të konsumit..etj.

- Mos hartimi dhe miratimi i Rregullores të Brendshme, në kuadër të ndryshimeve ligjore në drejtësi (në pritje të hartimit dhe miratimit të pershkrimeve standard të punës nga KLGJ-ja).

- Sistemet e kontrollit të brendshëm në fushën organizativ, hartimit dhe zbatimit të buxhetit, tarifave gjyqësore, pagave dhe shpenzimeve të funksionimit, kanë funksionuar mirë dhe janë efektive për arritjen e objektivave.

Për sistemin e raportimit financiar publik

- Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e raportimit financiar publik ka funksionuar por ka nevojë për tu përmirësuar, konkretisht: Regjistrimet e faturave të blerjes në kontabilitet nuk janë kryer sipas ekstremiteteve të tyre (me numer fature), për numër është vendosur numri i urdhër shpenzimit. Njëkohësisht flet hyrja e magazinës e regjistruar në kontabilitet nuk mban të njëjtin numer me faturën bashkëlidhur urdhër shpenzimit e cila është prerë manualisht dhe jo nëpërmjet programit elektronik ku mbahet kontabiliteti i gjykatës.

Për sistemin e prokurimeve publike

Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimeve publike ka funksionuar, por ka nevojë për tu përmirësuar, konkretisht: Për vitin 2020, si person pergjegjes për procedurat e prokurimit me vlerë

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

te larte dhe procedurat e prokurimit me vlere te vogel, është caktuar një Jurist jashtë strukturës të gjykatës. Referuar VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njëësia e prokurimit”, pika 3 “Personi/at përgjegjes per prokurimin kryen/jne detyrat”:*nuk rezulton ne asnje nen/pike/paragraf dhe eshte e pa mundur administrativisht/teknikisht që personi i punesuar me kohe te pjesshme dhe perkohesisht te kryej detyrat e personit përgjegjes per prokurimin ne Autoritetin Kontraktor “Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier”.*

Ne organike te gjykates ka Jurist dhe specialist te fushave te ndryshme, si: Ekonomist, Inxhinjer etj., per tu caktuar si person/a përgjegjes per prokurimin apo si anetare te komisionit per prokurimet me vlere te vogel, të cilët janë prezent çdo ditë në punë(*duhen trajnuar/kualifikuar,pa perjashtuar dhe asistencen nga APP-ja, gjetje dhe rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm*).

Autoriteti Kontraktor gjate vitit 2019 dhe 2020 ka realizuar nga 1(një) procedure prokurimi me vlere te larte, për çdo vit. Juristi jashte struktures te gjykates/eksperti i jashtem duhet te merrej si konsulent ligjor, anetar i njesise se prokurimit, vetem per procedurat e prokurimit me vlere te larte. Ne nje procesverbal te vecante, anetaret e njesise te prokurimit, caktojne njerin nga anetaret si person i autorizuar per te kryer veprimet ne SPE(Sistemin e Prokurimeve Elektronike), per proceduren e prokurimit.

Për vitin 2020 ne perberje te komisionit te prokurimit me vlere te vogel eshte caktuar dhe Juristi jashte struktures te gjykates - personi përgjegjes per prokurimin, si anetare i komisionit te prokurimit me vlerë të vogël. Referuar akteve ligjore dhe nenligjore në fushën e prokurimeve.....*nuk rezulton ne asnje nen/pike/paragraf dhe eshte e pa mundur teknikisht/administrativisht që personi i punesuar me kohe te pjesshme dhe perkohesisht te kryej te gjitha detyrat/hapat e nje procedure prokurimi me vlere te vogel*.

- Në proceduren e prokurimit me vlere te larte te zhvilluar nga AK ne vitin 2020, me objekt prokurimi “Rikonstruksioni i rrjetit ekzistues elektrik”, kërkesat e veçanta të kualifikimit nuk jane vendosur /percaktuar në përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne menyre qe te rritet pjesmarrja, sigurimi i konkuresces midis operatoreve ekonomik pjesmarres dhe barazia ne tender dhe per te stimuluar biznesin e vogel dhe te mesem. Nga mos perfshirja/marrja e nje specialisti te fushes (inxhinjer elektrik) ne njesine e prokurimit, per te percaktuar kriterete e vecanta te kualifikimit.

- Për procedurat e prokurimit me vlere te vogel, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar në një procesverbal të veçantë, specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, të përfshira ne FO. Nuk është dorezuar ne zyren e protokollit dokumentacioni i kerkuar ne Ftesen për oferte, nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm: Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna, masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe uljen e nivelit të riskut.

Rekomandimet: Jepen në Aneksin Nr.1 “Permbledhëse e Rekomandimeve”, të këtij projekt raporti.

Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e veprimtarisë gjyqesore, marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale; mbikqyrjen e administrimit te riskut dhe kontrolleve; sigurimin dhe administrimin efektiv te punes organizative dhe përgjegjesive. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale të gjykatës dhe i kanë dhënë menaxherit kryesor informacionin e duhur për menaxhimin me ekonomi, efektivitet dhe eficiency të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Nisur nga konstatimet të evidentuara në projekt raport auditim, mjedisi i përgjithshëm i kontrollit vlerësohet me nivel të mesëm risku.

II. Hyrje

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier u realizua auditim i kombinuar që përfshiu : zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm; sistemin e funksionimit të brendshëm organizativ; hartimin dhe zbatimin e buxhetit; të ardhurat dhe shpenzimet per pagat dhe pagesat e tjera; prokurimin e fondeve publike dhe raportimin financiar.

Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore të mëposhme :

Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligjin Nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe Ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me UMF nr.8 datë 29/03/2012 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar, me UMF nr.7 datë 28/02/2018 dhe udhëzimet vjetore per zbatimin e buxhetit.

Ligjin Nr.99/2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, i ndryshuar.

Ligjin Nr.88/2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i ndryshuar.

Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme”.

Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

VKM Nr. 914 date 29/12/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ligjin Nr. 9975 datë 28.07.2008 “Per taksat kombetare”, udhëzimi Nr. 13 datë 12.02.2009, ndryshuar me udhëzimin nr.991 date 02.03.2010 “Per percaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore”.

VKM përkatëse për pagat dhe shtesat mbi to, ndryshuar në vijimësi.

Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin 110 datë 15/10/2015 dhe Udhezimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Urdhërin e KM nr.4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

Urdhërin Nr. 1284/3 datë 16.03.2005 të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për masën e pagesës dhe faturës tatimore të lëshuar prej tyre.

Kuadri ligjor dhe rregullator mbi te cilin mbështete institucioni, Vendimet e KLGJ-se.

Për fillimin e misionit, grupi auditimit zhvilloi takimin prezantues në datën 24.05.2021 në gjykatë. Në takim u prezantua qëllimi dhe tematika e auditimit, ku palët ranë dakort për fillimin e misionit të auditimit, sipas programit të auditimit të miratuar dhe axhendës paraprake.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit të përbërë nga:

- Z. Agim Koçi - auditues, njëkohësisht përgjegjës grupi
- Z. Aristotel Telhaj - auditues
- Zj. Marjana Sulshabanaj - audituese

Afati i Auditimit : 01/01/2019 deri më 31/12/2020.

Në datën 04/06/2021 grupi i auditimit zhvilloj takimin përmbyllës të misionit të auditimit, në prani të Zv/kryetares të gjykatës, kancelares dhe kryetares së degës të buxhetit, ku u trajtuan problematikat e rezultuara gjatë auditimit, si dhe dakortesia për rekomandimet që do të lihen për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në gjykatë.

III. Metoda e Auditimit

Në misionin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika auditimi si : intervista, teste, llogaritje matematikore, sondazhe me përzgjedhje, etj.

Teknika e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (listë pagesat, përlllogaritjen e pagave, faturat, etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (për të gjitha sistemet e audituara sipas programit).

U plotësuan pyetësorët për mjedisin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të gjykatës, etj.

U vlerësua hartimi dhe zbatimi i plan veprimit mbi rekomandimet e dhëna në auditimin e mëparshëm. Grupi i auditimit gjykoi se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve.

IV. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për çdo sistem

4.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi i menaxhimit për rekomandimet e lëna ndaj gjetjeve të auditimit të mëparshëm, ndikimi i tyre në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe arritjes së objektivave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se: Gjykata është audituar nga DAB-ja në Shtator të vitit 2019, për periudhën 01.06.2015 deri më 31.12.2018. Raporti përfundimtar i auditimit i është dërguar subjektit të audituar me shkresën nr.6104.prot,datë 11.12.2019, ku janë lënë rekomandimet si vijon:

- Rekomandime të dhëna 26 (njëzet e gjashtë)
- Rekomandime të pranuar 26(njëzet e gjashtë)

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se: Gjykata ka reaguar ndaj rekomandimeve të lëna referuar plan veprimit të sugjeruar nga grupi i auditimit, ka miratuar plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet e realizimit, nje kopje e plan veprimit është dërguar zyrtarisht në KLGJ me shkresën nr.5682/1, datë 15.01.2020.

Lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr.2957/1, datë 15/06/2020, gjykata ka dërguar informacion DAB-së për progresin e bërë.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezulton se:

- rekomandime të zbatuara plotësisht 22(njëzetedy) ose 85%
- rekomandime në proces zbatimi 3(tre) ose 12%
- rekomandime të pa zbatuara 1(një) ose 3%

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Më konkretisht verifikimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm është si vijon:

Per sistemin organizativ:

Rekomandimi nr.1: Gjykata për aspekte të veprimtarisë ku do jetë e nevojshme për të përmbushur rregullat e përgjithshme të administrimit dhe menaxhimit financiar, të veproje me nxjerrjen e urdhërave përkatës sipas nevojave që do të lindin në praktikën e përditshme të veprimtarisë të gjykatës në përputhje me bazen ligjore respektive, deri në miratimin e rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave nga KLGJ.

Statusi: Zbatuar plotësisht (Në mungesë të rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, Gjykata ka vepruar me nxjerrjen e urdhërave përkatës sipas nevojave që kanë lindur në praktikën e përditshme të veprimtarisë të gjykatës).

Rekomandimi nr.2: Të kërkohet në organin kompetent (KLGJ), shtesë në organike me të paktën l(nje) sekretare gjyqesore, për mbulimin e shërbimit ndaj publikut, në sportelin ku ofrohen shërbimet gjyqesore. Kjo e fundit të shërbeje/jete si zëvendësuese për sekretaret gjyqesore që do kompesohen me pushime, për orët shtese, të kryera jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare. Kërkesa të bëhet në momentin e plotësimit të vendeve vakant, me gjyqtare.

Statusi: Zbatuar plotësisht ; (shkresa nr. 10260 prot. datë 19.12.2019, dërguar KLGJ-së, shtese organike për mbulimin e shërbimit ndaj publikut, kerkese e cila është miratuar në 2021).

Rekomandimi nr.3: Në përputhje me Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqesor në Republikën e Shqipërisë”, nëni 85, pika 2 “Statusi i punonjesve të tjerë në detyrë në gjykata”. Keshilli i Gjykatës të beje vlerësimin e plotësimit të kriterëve formale të punonjesve në detyrë për pozicionin që kryejnë, me përjashtim të kancelares. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Keshilli i Gjykatës të vlerësojë mundësitë ekzistuese për sistemin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale nëse nuk ka arsye për perfundimin e marrëdhënieve të punës.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (Në mbledhjen e datës 30.12.2019, Keshilli i Gjykatës ka kryer vlerësimin e plotësimit të kriterëve formale të punonjesve në detyrë për pozicionin që kryejnë).

Rekomandimi nr.4: Deri në miratimin e rregullave të hollësishme nga KLGJ-ja për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, të dhenat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhenave. Të kompletohen dosjet personale të punonjesve administrativ në përputhje me standardet e kerkuara për regjistrin kombëtar të punonjesve publik, bazuar në VKM-në Nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe të regjistrit qendror të personelit”.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (Janë plotësuar dosjet e personelit sipas VKM-në Nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe të regjistrit qendror të personelit”, trajtuar në pikën 2. sistemi organizativ).

Rekomandimi nr.5: Për rritjen e kushteve të sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit të gjykatës, në bashkëpunim me KLGJ-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe Pushtetin Vendor, të kërkohet në vazhdimësi për *ndertimin* apo sistemin/vendosjen e gjykatës në një godinë tjetër. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, të merren masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykate. Hyrja e gjyqtarëve dhe e punonjesve të administratës të bëhet nga hyrja kryesore/ballore e gjykatës dhe jo nga dera ku futen palet ndergjyqese. Në vendqendrimin e punonjesit të sigurisë, të shikohet mundësia për vendosjen e

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

nje monitori me te gjitha paisjet perkates me akses vezhgimi te kamerave te sigurise ne te gjitha ambientet e gjykates, si dhe nje aparati telefonik, per komunikimin e brendshem.

Statusi: në proces zbatimi; (Gjykata ka kërkuar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Drejtësisë zhvendosjen në një godinë tjetër për shkak të ambienteve të pamjaftueshme për salla gjykimi, zyra, ambjent archive, magazine etj, akoma nuk është dhënë zgjidhje nga organet kompetente.(trajtur në pikën 2, sistemi organizativ).

- nga ana e gjykates për rritjen e sigurisë është vendosur Access Control ne hyrjen ballore te Gjykates, si dhe jane marre disa masa te tjera ne kopetence dhe mundesive te saj).

Për sistemin e hartimit dhe zbatimit të Buxhetit:

Rekomandimi nr.6: Procesi i hartimit i PBA-ve te filloje me ngritjen e (EMP) ekipit te menaxhimit te programit dhe ndarjen e detyrave te antareve te EMP nga Drejtuesi programit(Kryetari) nepermjet urdherit te brendshem. Shperndarjen tek te gjithë anetaret e EMP te dokumentave dhe materialeve te nevojshme per procesin e programit buxhetor afatmesem, hartimin e nje kalendari aktivitetesh per anetaret e EMP per te garantuar respektimin e afateve te percaktuara ne kalendarin e njesise qendrore(KLGJ). Dokumentimi i punes per detajimin e produkteve te programit dhe llogaritjes se kostos perkatese te tyre. Miratimin e treguesve te PBA-ve nga GMS dhe hartimin e P.V te miratimit. E gjitha kjo procedure(si me sipër) se bashku me tavanet e derguara dhe udhezimin qe shoqeron ato duhet te arkivohet ne dosjen e hartimit te PBA-ve perkatese.

Statusi: Zbatuar plotësisht;(Me urdherin nr. 1997, date 02.04.2020 eshte krijuar EMP – Ekipi i Menaxhimit te Programeve per periudhen ne vijim, dhe jane ndare detyrat per anetaret e EMP nga Titullari, hartimin e nje kalendari aktivitetesh per respektimin e afateve te percaktuara nga KLGJ).

Për sistemin e pagesave:

Rekomandimi nr.7. Shtesa e pagës për vështiresi e dëmshmeri në punë për pozicionet e punës, nëpunës gjyqësor dhe sanitarë të llogaritet e paguhet ne perputhje me piken 9 (a,b dhe c) te VKM-se nr.717, date 23.06.2009 “Per pagat e punonjesve mbeshtetes te institucioneve buxhetore dhe nepunesve te disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar. Te nderpritet pagesa e shteses se pages per veshtiresi e demshmeri ne pune deri ne marrjen e miratimeve perkatese.

Statusi: Zbatuar plotësisht;(Me urdhërin e Zv/kryetares së gjykates drejtuar deges së buxhetit nr.ska,date 02.12.2019, është ndërprere pagesa për veshtiresi e demshmeri ne pune deri në marrjen e miratimeve nga institucionet përkatëse. Me shkresën nr. 8563, prot.datë 21.10.2019, në mbeshetje të VKM-se Nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbeshtetes të Institucioneve Buxhetore”, te ndryshuar, pika 9, paragrafi “a”, i është kerkuar Njesise Vendore te Kujdesit Shendetesor Fier percaktimi i shkalles e veshtiresise dhe demshmerise per pozicionet e mesiperme te punes. Prej ketij institucioni eshte kthyer pergjigje me shkresen nr.169, date 13.01.2020,me shkresën nr. 4789/1 date 08.10.2020, KLGJ ka miratuar proceduren për përcaktimin e shkallës së veshtirësisë në punë nga institucionet perkatese).

Rekomandimi nr.8: Të ndërpritet pagesa e orëve jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare, per punojesit e administrates gjyqesore. Oret e punes qe do te kryhen jashte kohes normale te punes, ne dite pushimi e festa zyrtare te kompesohen me pushim. Puna/ngarkesa ne kohen kur punonjesve do tu jepet pushimi, te mbulohet/perballohet nga 3(tre) sekretaret gjyqesore qe jane aktualisht te lira/te pa mbuluara me pune, si rezultat i mungeses te 3 (tre) gjyqtareve. Procedura/dokumentimi, trajtimi dhe kompesimi i punes se kryer mbi kohen normale te punes te behet ne perputhje me VKM-ne Nr. 463 date 16.06.2011 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr. 511, date 24.10.2002 “Per kohezgjatjen e punes dhe te pushimit ne Institucionet shteterore”, te

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

ndryshuar, Udhezimin e Ministrit te Financave Nr. 16, date 20.07.2011 "Mbi zbatimin e vendimit Nr.463, date 16.06.2011 te Keshillit te Ministrave".

Statusi: Zbatuar plotësisht; (*Urdheri nr. 534 prot. date 01.10.2019 i zv. Kryetares se Gjykates "per kohezgjatjen e punes dhe te pushimit", puna e kryer në ditë pushimi e festa zyrtare nga administrata gjyqësore nga dalja e këtij urdhëri është kompensuar me pushim).*

Rekomandimi nr.9: Deri ne miratimin e nje procedure standarte nga KLGJ, Keshilli Gjykates duhet te miratoje me akt te brendshem nje procedure ne lidhje me menyren e kryerjes se njoftimeve, mbajtjen e regjistrit te brendshem te gjykates per njoftimet ku te evidentohen ato qe dergohen me poste, shperndahen nga nepunesi/ftuesi i gjykates, menyren e vjeljes se shpenzimeve te njoftimit, dhe perjashtimet nga keto shpenzime sipas legjislacionit ne fuqi dhe pas rakordimit me kete regjister te rregjistrit postar te konfirmohet fatura e shpenzimeve postare.

Statusi: Në proces zbatimi; (*Nuk ka një akt të brendshëm në lidhje me procedure e kryers së njoftimeve, gjykata ka kryer rakordimin e rregjistrit postar me rregjistrin e brendshem në gjykatë më pas ka konfirmuar faturën e shpenzimeve postare).*

Rekomandimi nr.10: Punonjësit që dergohen me shërbim, të autorizohen per çdo rast nga Kryetari i gjykates ne zbatim te VKM nr. 997 date 10/12/2010 "Per trajtimin financiar te punonjesve qe dergohen me sherbim jashte qendres se punes, brenda vendit" te ndryshuar, pika V, nenpika 1,2/a/iii ku te percaktohet qarte qellimi i sherbimit dhe kohezgjatja e tij. -Punonjesit qe dergohen me sherbim menjehere pas perfundimit te sherbimit duhet te plotesojne urdher-sherbimin ta miratojne ate dhe ta paraqesin ne degen e buxhetit se bashku me dokumentacionin autorizues dhe vertetues te shpenzimeve te kryera.

-Dega e buxhetit me marrjen e urdher sherbimeve duhet të bej kontrollin e rregullshmerise, ligjshmerise te dokumentacionit autorizues dhe vertetues dhe pasi te sigurohet se plotsohen keto kushte duhet te vazhdoj me kryerjen e procedurave te metejshme e ne rast te kundert duhet ti kthej mbrapsht ato.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (*në çdo rast është respektuar procedura sipas akteve ligjore në fuqi).*

Rekomandimi nr.11: Punonjesi(Kancelari) qe leshon dokumentin autorizues (urdher dorzimet apo liste shperndarjet) duhet te percaktoje sakte pershkrimin e artikullit dhe sasine e tij si dhe subjektin ku shkon malli dhe terheqesin e tij(automjetin me Targe, Sekretaren e gjyqtarit, Zyren, etj). Magazinjeri pret F.Daljen dhe nxjer mallin nese urdher dorezimi eshte i qarte i sakte duke plotesuar adresen ku shkon malli (Automjetin me targe, sekretaren e gjyqtarit, Zyren etj., dhe merr nenshkrimin e marresit/terheqesit te mallit apo materialit ne te kundert njofton K/D/Buxhetit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi nr.12: GMS(grupi menaxhimit strategjik) te trajtoje nevojën e mbajtjes se numrave telefonike fiks dhe per numrat te cilet jane te panevojshem te kerkoje nderprerjen e kontrates me operatorin ekonomik me qellim eliminimin e shpenzimeve te panevojshem dhe perdorimin me eficese e dobi te burimeve financiare.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (*Me shkresen nr.9461 prot. datë 19.11.2019, drejtuar kompanise Albtelecom sha, e cila ka bere shkeputjen e 4 numrave te telefonise fikse. Jane lene ne funksion vetem 2 numra fiks, 1 per komunikim per institucionin dhe 1 per internetin).*

Rekomandimi nr.13: Për përdorimin e paautorizuar të mjeteve private dhe konsumin e karburantit për to, Keshilli gjykates te marre ne analize kryerjen e ketyre shpenzimeve dhe te nxjerre pergjegjesite

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

qe kane punojesis perkates te cilet kane pergjegjsine dhe detyrimin per menaxhimin me efektivitet, efience dhe ekonomi te aktiveve te gjykates.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (*Këshilli i gjykates ka reaguar menjehere duke nderprere praktiken e perdorimit te mjeteve private, mjetet në pronesi të gjykates janë përdorur me autorizim nga titullari për cdo levizje ku është përcaktuar destinacioni dhe arsyeja e lëvizjes*).

Rekomandimi nr.14: Ne zbatim të VKM nr 561 date 27.07.2016, “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së pergjithëshme” i ndryshuar kartat aktuale të behen inaktive (mbyllen) dhe pas kesaj ti drejtohet operatorit ekonomik me kerkese zyrtare per paisjen me karta te personalizuar me targat e autoveturave dhe emrin e perdoruesit. Te autorizohet me urdher te brendshem te titullarit punonjesi qe do te merret me menaxhimin e sistemit elektronik te shpenzimeve te karburantit(Kancelarin) i cili rast pas rasti duhet te dorezoje kuponin tatimor te shitjes qe jep operatori ekonomik te cilat sebashku me raportin qe merret nga sistemi elektronik dhe nenshkruar nga Kancelari duhet ti bashkelidhen Flet Daljes mujore te karburantit te prere per cdo autovetur me vete. Fletet e udhëtimit te cdo autoveture te plotesohen nga shoferi duke plotesuar daten dhe intenerarin e levizjeve, km e pershkuara, sasite e furnizimit me karburant, te neshkruhen nga ai per cdo date, nga urdheruesi per levizjet e brendeshme dhe nga nepunesi udhetues per levizjet jashte rrethi ne rastet e komandimeve dhe ne fund te çdo muaji te dorezohen ne degen e buxhetit per kryerjen e monitorimit te konsumit te karburantit.

Statusi: Zbatuar plotësisht;(*urdhëri nr.5379,date 27.11.2019, Për menaxhimin e sistemit elektronik të karburantit, ku përcaktohet kancelarja si personi përgjegjes për menaxhimin e sistemit elektronik për shpërndarjen e karburantit, shkresa nr.9703,date 27.11.2019, “Kërkesë për ndryshimin e kartave elektronike” Bolv Oil sh.p.k.*).

Për sistemin e prokurimeve:

Rekomandimi nr.15: Perpara nxjerrjes se urdhrit te prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, njesia e prokurimit apo komisioni i ngritur per llogaritjen e fondit limit, pasi te kete siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e references te perlllogaris fondin limit per sasine e mallrave, sherbimeve, puneve qe do te prokurohen, ne perputhje me nenin 59 te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar. Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu III-te, nenin 23 “Specifikimet teknike”. Kerkesat per pune, mallra apo sherbime te jene sa me te qarta dhe te kene nje pershkrim me te hollesishem te punes, mallit apo sherbimit qe kerkohet te prokurohet. Ne perputhje me te cilat te hartohen specifikimet teknike/termat e references dhe te behet perlllogaritja e fondit limit.

Statusi: Zbatuar plotësisht; (*trajtuar në pikën 6, sistemi i prokurimeve*).

Rekomandimi nr.16: Njësia e Prokurimit të tregojë me shume kujdes ne vendosjen dhe argumentimin e kriterëve te vecanta per kualifikim, kerkesat te jene ne perputhje me nenin 1 pika 2 “c”, “9”, “d”; nenin 20 te Ligjit Nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar; piken 3 te nenit 27 dhe nenit 61 te VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e veçanta te pranimit per objektin qe prokurohet te vendosen ne perputhje me nenin 46 te LPP, ku citohet se “.. ..Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatorët ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve”. Ne menyre qe te eliminohen zgjatjet e panevojshme te procedurave te prokurimit, sigurimi i konkuresces dhe barazia ne tendera.

Statusi: Në proces zbatimi; (*ka përmirësim nga auditimi i mëparshëm, trajtuar në pikën 6, sistemi i prokurimeve*).

Rekomandimi nr.17: KVO-ja te jete me e kujdesshme ne vleresimin e ofertave, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Operoret ekonomike, te kualifikohen pasi te kene permbushur te gjitha kriteret te vendosura nga autoriteti kontraktor.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Rekomandimi nr.18: Të monitorohet/mbikqyret cilesia e realizimit te kontrates se sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizikese te ambjenteve te gjykates ne perputhje me nenin 77 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar.

Statusi: Zbatuar plotësisht; *(Me urdherin e titullarit nr.29 prot. date 16.01.2020, eshte ngritur Komisioni i marjes ne dorezim te mallrave dhe sherbimeve te prokuruar. Lidhur me sherbimin e rojeve ky komision ka bere mbikeqyrjen e sherbimit te ruajtjes fizike te ambjenteve te gjykates dhe ne fund te muajit eshte mbajtur nje procesverbal, i cili eshte bashkëngjitur faturave tatimore të operatorit ekonomik).*

Rekomandimi nr.19: Kryetari i AK ne perputhje me nenin 68 te VKM-se 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, per te pasur mundesine e ndarjes se punes te punonjesve qe do te perfshihen ne procedurat e prokurimit qe do te zhvilloje gjykata. Ti kerkoje APP-se per trajnimin e punonjesve, kjo ne perputhje me nenin 83 te VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar. APP-ja ofron dhe asistence online ne fushen e prokurimeve.

Statusi: Pa Zbatuar; *(është marrë specialist i jashtëm për prokurimet, trajtuar në pikën 6, sistemi i prokurimeve).*

Rekomandimi nr.20: Në rastet kur, ne perllogaritjen e fondit limit perdoret metoda e testimit te tregut nga komisioni i prokurimit me vlere te vogel. Ne procesverbalin e perllogaritjes te fondit limit te dokumentohen treguesit e çmimeve. Fondi limit te perllogarithet ne perputhje me nenin 59 te VKM-se Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Rekomandimi nr.21: Për blerjet me vlere te vogel, kerkesat per pune, mallra apo sherbime të jene te qarta dhe të kenë nje pershkrim me te hollesishem te punes, mallit apo sherbimit qe kerkohet te realizohet(kerkesa te hartohet nga sektori perkates e te miratohet nga Kancelari). Ne baze te te cilave te hartohen specifikimet teknike/termat e references dhe perllogarithja e fondit limit. Ne perputhje me piken 5 te Udhezimit Nr.3 date 08.01.2018 "Mbi perdorimin e procedures se prokurimit me vlere te vogel dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Rekomandimi nr.22: Për shërbimet e riparimit dhe të mirmbajtjes ,si riparimi i mjeteve të transportit, mirmbajtja e pajisjeve elektronike, elektrike, teknike, pajisjeve të sigurisë ..etj, të mbahet procesverbali i konstatimit të difektit apo shërbimit qe kerkohet te kryhet si dhe procesverbali per punën e kryer në fakt nga ofruesi i shërbimit, konfirmuar nga marresi ne dorezim/përfaqësuesi i gjykatës përpara se të kryhet pagesa.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Rekomandimi nr.23: Komisioni i prokurimit me vlere te vogel, perpara se te njoftojë ofertuesin e renditur ne vendin e dyte ne listen e ofertave dhe keshtu me radhe deri ne ofertuesin e renditur ne vendin e dhjete, te evidentojte ne procesverbal mos njoftimin e operatorit ekonomik brenda afatit kohor te percaktuar ne ftesen per oferte ose arsyet e skualifikimit te operatorit ekonomik paraardhes.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Rekomandimi nr.24: Te printohet dhe te behet pjese e dosjes “Raporti perfundimtar i procedures se prokurimit”, te gjeneruar nga sistemi elektronik, ne perputhje me Udhezimin Nr.1, date 14.04.2017 “Per zhvillimin e propedurave te prokurimit me vlere te vogel ne sistemin elektronik”, i ndryshuar.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Për sistemin e TI-se:

Rekomandimi nr.25: Gjykata për të rritur sigurinë fizike dhe llogjike ne dhomen e serverit ne drejtim te uljes se riskut te aksesit te paautorizuar, vendosjes vetem te pajisjeve te percaktuara ne kete ambient, ngritjes se sistemit te pershtatshem kondicionimi, vendosjes se sistemeve te mbrojtjes e sinjalizimit. Te marre masa per permiresimin e kushteve ne dhomen e serverit, duke analizuar dobesite, te hartohet nje plan veprimi ne perputhje me specifikimet ne rregulloren e AKSHIT per “Ndertimin e dhomes se serverit”.

Statusi: Në proces zbatimi; *(Për shkak të pezullimit të procedurave të prokurimit si pasojë e pandemisë Covid-19, nuk është realizuar procedura e prokurimit, është realizuar hartimi i projektit).*

Rekomandimi nr.26: Per monitorimin dhe disiplinimin e hyrje - daljeve te personelit ne organike te Gjykates. Te ç’instalohet sistemi elektronik me karte akses kontrolli, nga dera ku futen te pandehurit/ndaluarit dhe palet ndergjyqese dhe te instalohet ne deren kryesore/ballore te gjykates nga do te behet hyrja e punonjesve te administrates dhe e gjyqtareve. Nese kjo eshte e pa mundur te realizohet nga ana teknike, te mundesohet blerja e nje sistemi te ri elektronik me karte akses kontrolli.

Statusi: Zbatuar plotësisht;

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve: *Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna, masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe uljen e nivelit të riskut.*

4.2. Sistemi organizativ

Gjykata, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar në bazë të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ligjin Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Ne mungese te nje Rregullore te Brendshme te unifikuar per te gjitha gjykatat, ne nevoje te gjykates, eshte hartuar rregullorja “Për veprimtarine administrative të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Fier”, miratuar nga ish Kryetari i gjykatës me nr.prot. 2530, date 12.12.2014. Kjo rregullore eshte hartuar ne zbatim te Ligjit Nr. 9877 datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar. Për zbatimin dhe përmirësimin e rregullores në vazhdim janë nxjerrë Urdhëra : nr.prot. 3783 date 30.12.2015; nr.prot.4691 datë 20.11.2017; nr.prot. 4699 datë 20.11.2017; nr.4689/1, prot. datë 23.11.2017; nr.prot.457 datë 04.09.2017; nr.prot.2666 datë 06.07.2017; nr.prot. 2550 datë 29.05.2018; nr.prot.5039 datë 09.11.2018.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Ne kushtet e një situate të re juridike, në kuadër të reformës në drejtësi dhe në përputhje me nenin 37 germa “dhe” të Ligjit Nr.98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor ne Republikën e Shqipërisë”, rishikimi dhe përmirësimi i rregullores ekzistuese është e domosdoshme për mirefunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në gjykate, për sa kohë që kjo rregullore do të jetë në fuqi, për ato pjesë të saj që nuk bien ndesh me ligjin dhe që janë të zbatueshme.

Për aspekte të veprimtarisë ku do jetë e nevojshme për të përmbushur rregullat e përgjithshme të administrimit dhe menaxhimit financiar, vazhdohet të veprohet me nxjerrjen e urdhërave përkatës sipas nevojave që lindin në praktikën e përditshme të veprimtarisë të gjykatës në përputhje me bazën ligjore respektive deri në hartimin dhe miratimin e Rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, nga KLGJ (me miratimin e përshkrimeve standarde të punës të punonjësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës (*rishikimi dhe përmirësimi i rregullores është trajtuar dhe rekomanduar në auditimin e kaluar, për këtë arsye nuk lihet rekomandim nga grupi auditimit*).

a). Struktura dhe organika e gjykatës

Struktura dhe organika e Gjykatës për periudhën objekt auditimi është miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me Urdhërin nr.1477/1, datë 02.03.2015 “Për miratimin e strukturave dhe organikën e gjykatave të shkallave të para dhe gjykatave të apelit”, me 41 punonjës. Në vazhdim me shkresën e KLGJ-se nr.prot.2534, date 06.05.2019, është shtuar 1(nje) punonjës sigurie; me shkresën nr.prot.167, date 09.03.2020, është shtuar 1(nje) arkivist dhe 2(dy) nepunes gjyqësor. Nga 45 punonjës të miratuar në organikë të gjykatës, në fakt janë 44. Me vendimin e datës 10.09.2020, KPA ka shkarkuar nga detyra Kryetarin e Gjykatës, vend i cili aktualisht është vakand dhe mbulohet nga zv/Kryetarja e gjykatës. Organika e gjykatës gjatë periudhës objekt auditimi është shtuar me 4(katër) punonjës **dhe është respektuar në përputhje me miratimet e bëra.**

b). Praktika e menaxhimit të burimeve njerëzore, zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në lidhje me rekrutimet e reja, largimet nga puna, vlerësimet dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Mbi procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve.

Gjatë periudhës objekt auditimi janë rekrutuar 8(tete) punonjës, nga keto 6(gjashte) në vitin 2019 dhe 2(dy) në vitin 2020 (4 punonjës nga shtesa e organikes, 2 nga daljet në pension pleqërie dhe 2 nga largimet me dëshirë), konkretisht: gjatë vitit 2019 janë rekrutuar 2(dy) sekretare gjyqësore, 2(dy) nepunes gjyqësor, 1(nje) punonjës sigurie dhe 1(shofer). Gjatë vitit 2020 janë rekrutuar, 1(nje) punonjës sigurie dhe 1(nje) nepunes gjyqësor. Me zgjedhje u audituan 4(katër) dosje/procedura rekrutimi, 2(dy) për vitin 2019 dhe 2(dy) për vitin 2020. Nga këto rezultoi se: për rekrutimin e punonjësve të rinj është ngritur komisioni ad-hoc, për hartimin e kriterëve të veçanta/specifike të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, për publikimin e vendeve vakant në faqen zyrtare të gjykatës dhe në këndin e njoftimeve të gjykatës, hartimin dhe miratimin e procedurave të konkurimit me shkrim dhe intervistës me gojë, mbledhjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kërkuar në njoftimin e publikuar, dokumentimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave. Procesi i përzgjedhjes i është nënshtruar procedurës konkurruese të rekrutimit, transparente dhe merite, duke vepruar në përputhje me nenin 19, pika 2 të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me Ligjin nr.98/2016, date 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Me fillimin/krijimin e funksionimit të Keshillit të Gjykatës në vitin 2019, emerimi i punonjësve është bërë nga ky i fundit në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës për punonjësit e gjykatës, kurse rekrutimi i punonjësve të tjerë të administratës (nepunesit civil gjyqësor) është bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Keshilli i Gjykates bazuar ne nenin 38, pika b dhe nenin 50, te ligjit nr.98/2016, date 06.10.2016 “Per organizimin e pushtetit gjyqesor ne RSH”, ka verifikuar dosjet personale te punonjesve dhe ka vendosur per punonjesit ne detyre qe plotesojne kriteret formale ligjore te parashikuara ne ligjin nr.98/2016, date 06.10.2016 “Per organizimin e pushtetit gjyqesor ne RSH”, si dhe kriteret e pergjitheshme dhe te veçanta te parashikuara ne Vendimin nr.338, date 24.09.2020, te KLGJ-se “Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave per dhenjen e statusit te nepunesit civil gjyqesor, punonjesve ne detyre ne gjykate”. Per te gjithë kategorite e punonjesve te parashikuar ne ligj dhe ne vendimin e mesiperm, eshte vendosur tu jepet statusi i nepunesit civil gjyqesor. Nuk rezultuan parregullsi ne lidhje me procedurat per dhenjen e statusit te nepunesit civil gjyqesor, për punonjesit ne detyre. Per punonjesit qe nuk permbushin kerkesat ligjore, jane ndjekur udhezimet e KLGJ-se.

Mbi procedurat e ndjekura për largimet nga puna.

Gjate periudhes objekt auditimi jane larguar nga puna 8(tete) punonjes, nga keto: 6(gjashte) gjate vitit 2019 dhe 2(dy) gjate vitit 2020. U verifikuan me zgjedhje 4(kater) praktika/dosje punonjesish te larguar nga puna. Nuk rezulton të jetë larguar nga puna asnje punonjes per shkelje te disipline ne pune. Punonjesit e larguar nga puna, jane larguar me deshire/kerkesen e tyre ose ne pension pleqerie. Per 4(kater) dosjet e audituara nuk rezultuan parregullsi ne lidhje me nderprerjen e marredhenjeve te punes, me punonjesit e larguar.

c). Dosja dhe Regjistri i Personelit

Nga auditimi rezulton se dosjet e nepunesve civil gjyqesor dhe dosjet e punonjesve te gjykates janë plotësuar me te gjitha dokumentat që duhet të përmbajë dosja personale.

Sipas të dhënave qe ju paraqitën grupit të auditimit, rezulton se eshte krijuar regjistri themeltar i punonjësve, në përputhje me nenin 36 “Regjistri”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.136/2015.

Regjistri themeltar i punonjësve është plotësuar në të gjitha referencat e tij, është sekretuar dhe vulosur me vulën e institucionit në të gjitha faqet, gjendja e regjistrit themeltar eshte e mirë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 63 “Dosja dhe Regjistri Qendror i Personelit”, është krijuar regjistrit elektronik i personelit, ka filluar hedhja e të dhënave profesionale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës për punonjësit.

Në mbështetje të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 63, pika 4, KLGJ-ja do të miratojë rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhënave.

d). Vlerësimi nga ana funksionale e gjykatës

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier, ushtron veprimtarinë në nje godine dy kateshe, ne kete ndertese ushtrojne aktivitetin e tyre dhe dy institucione te tjera, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor dhe Zyra e Permbarimit Fier, me hyrje te veçanta. **Ambientet ne inventar te gjykates janë të pamjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë normale të punës.**

Aktualisht trupa gjyqësore e kësaj gjykate përbehet nga 13 gjyqtarë (përfshirë dhe z/kryetaren, ne strukture jane 14). Gjykata duhet të përballojë fluksin e punes me 5 salla gjykimi gjithsej, ndërkohë një gjyqtarë gjykon mesatarisht 5 deri në 7 çështje gjyqësore në ditë, per shkak te ngarkeses nje pjesë e gjykimeve, jo në përputhje me standardet e kërkuara, behen në zyrat e gjyqtarëve.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Mungesa e ambienteve ka krijuar probleme ne arkivimin e dosjeve të përfunduara, një pjesë e tyre mbahen ne kryesekretari dhe ne paradhomen e saj(dosjet gjyqesore te vitit 2019 dhe 2020). Perveç zyres te arkives jane krijuar dhe kater ambiente te tjera miniarkiva, per arkivimin e dosjeve.

Ne pamundesi te ambjenteve palëve apo përfaqësuesve të tyre/avokateve nuk u sigurohet një ambient për studimin e dosjeve.

Per mbajtien e materialeve te konsumit, perdoret nje ambient i vogel qe nuk ploteson asnje kusht per magazinimin e tyre.

Specialistia e IT eshte vendosur ne ambjentet/sportelin e sherbimit ku behet pranimi i kerkes padive, bashke me sekretaren regjistruese.

Nisur nga ngarkesa e punës/shtimi i aktivitetit të gjykatës, del si domosdoshmeri :

-Sigurimi i të pakten dhe i 2(dy) sallave te tjera gjykimi.

-Sigurimi i një ambjent me të bollshëm, per magazinimin e materialeve te konsumit.

-Sigurimi i nje ambjenti me te bollshem per Arkivimin e dosjeve gjyqesore.

-Sigurimi i nje ambjenti/zyre per specialisten e IT-se.

-Sigurimi i një ambjenti të veçantë për palët apo përfaqësuesve të tyre/avokateve për studimin e dosjeve, per qendrimin e psikologeve, prokuroreve...etj.

Në vlerësimin e përgjithshëm, godina e gjykatës nuk garanton elementët e sigurisë dhe zhvillimin normal te aktivitetit, për sa i përket:

- Hyrje-daljeve të veçanta për palët në gjykatë,
- Hyrje-daljeve të veçanta për gjyqtarët dhe administratën gjyqësorë,
- Mos disponimi i një vendi të përshtatshëm për shqyrtimin e dosjeve nga avokatët, per qendrimin e psikologeve, prokuroreve etj.
- Mos disponimi i aksesit të duhur për personat me aftësi të kufizuar, per hyrjen e kësaj kategorie në sallat e gjykimit në katin e dytë të godinës. Rrafsh i pjerrët sherben vetem per futjen e kesaj kategorie ne sallat e gjykimit ne katin e pare.
- Hyrja nga e njejta porte(porta e jashme) e stafit te gjykates dhe e zyres se permbarimit shteteror Fier, perfshire ketu dhe perdoruesit e jashem te dy institucioneve. Gjithashtu nga e njejta porte behet hyrja e perdoruesve te dy zyrave avokatie qe ndodhen ne oborrin e gjykates.

Për kushtet e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë, nuk lihet rekomandim, ky problem eshte trajtuar dhe lëne rekomandim ne auditimin e kaluar. Gjykata të vazhdoj të kërkoj ne organet kopetente për ndertimin e një godine te re apo zhvendosjen e aktivitetit në një godinë funksionale.

4.2.2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar me ligjin nr.110/2015 u krye auditim mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjykata, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe derguar brenda afateve ligjore ne organin qendror pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhen objekt auditimi(shkresa nr.prot.243,date 15.01.2020).

Pesë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (që këtej e tutje MFK) janë: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni e komunikimi dhe monitorimi.

a). Mjedisi i kontrollit

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II-të, neni 8, pika 8(b), i ndryshuar me ligjin 110/2015. Me urdherin nr.prot.2932/1, date 05.06.2019 është ngritur *Grupi i Menaxhimit Strategjik (G.M.S)* në përbërje të të cilit është zv/Kryetaria e Gjykatës në rolin e Nëpunësit autorizues, Kancelarja në rolin e Menaxherit dhe K/D/Buxhetit në rolin e Nëpunësit zbatues.

Çështjet kryesore dhe problemet që kanë dalë brenda njësisë i janë parashtruar GMS, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave përkatëse, në përputhje me nenin 27, pika 1 të ligjit për MFK-në. Nga auditimi rezulton se GMS ka organizuar takime herë pas here për të diskutuar problemet, sipas përcaktimeve në urdhërin e ngritjes të GMS. Në lidhje me identifikimin e objektivave, risqeve, analiza, vlerësimi dhe menaxhimi i tyre.... etj.

Dokumentimi i çështjeve të trajtuara dhe zgjidhjet e dhëna, janë evidentuar rregullisht në procesverbalet e çdo mbledhje.

b). Menaxhimi i riskut

Risiet të identifikuarra janë marrë parasysh në hartimin e objektivave afatmesëm, brenda kapaciteteve dhe mundësive të gjykatës. Risiet e identifikuarra dhe çështjet që kanë të bëjnë me risiet në arritjen e objektivave, janë trajtuar në mbledhjet javore të organizuara nga zv/Kryetaria i Gjykatës. Rezultatet dhe konkluzionet e mbledhjeve, i’jan komunikuar stafit për të ndërgjegjësuar praninë e risieve.

Në lidhje me menaxhimin e riskut, për periudhën nën auditim është hartuar regjistri i riskut, në përputhje me kërkesat e nenit 11, pika 2 dhe nenit 12, pika 3(d) të ligjit “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” i ndryshuar, i cili është dërguar brenda afateve ligjore në formë elektronike dhe shkresore në organin qendror.

Në regjistrin e riskut janë evidentuar risiet e mundshme që mund të ndodhin, konkretisht: miratimi i buxheti me të ulet se planifikim; rritja e volumit të ceshtjeve gjyqësore, sjell kosto me të larte për njësi produkti/me shume shpenzime se sa plani ...etj.

Për rastet/risiet të evidentuara në regjistrin e riskut, janë marre masat e nevojshme për minimizimin/menaxhimin e tyre, ka ende nevojë për një kuptim më të plotë dhe trajtime specifike në fushën e menaxhimit të riskut.

c). Aktivitetet e kontrollit

Një kontroll i rëndësishëm mbi aktivitetin e gjykatës, është ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësive të personelit.

Në Rregulloren e Brendshme janë të perfshira detyrat që kryen secili punonjë/pershkrimet e punës. Struktura mbi të cilën funksionon institucioni, lë pak vënd për mosperfshtirjen e një punonjësi në më shumë se një detyrë njëkohësisht.

Në gjykatë, rendesi i është kushtuar kontrolleve parandaluese dhe zbuluese, kryesisht kanë të bëjnë me kushtet e sigurisë në gjykate, për shkak të funksionit dhe kushteve që ka gjykata aktualisht(*ne nje godine kryhet aktiviteti i tre institucioneve*).

d). Informacioni dhe komunikimi

Mekanizmat e kontrollit të përgjithshëm janë zbatuar në të gjitha operacionet dhe kanë kontribuar në zbatimin e duhur të tyre. Në gjykate kontrollet janë ushtruar në drejtim të ruajtjes së të dhënave të hyra në servere-t e sistemeve, e konkretisht është kryer back-up i të dhënave të sistemit qendror të gjykatës, të sistemit (sistemi elektronik i çështjeve gjyqësore), në të cilën regjistrohen të gjitha çështjet gjyqësore dhe ecuria e tyre. Back-up është ditor si lokalisht ashtu

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

edhe nëpërmjet rrjetit të krijuar nga AKSHI. Testimi i këtij procesi është automatik, dhe kryhet nga vetë sistemi, duke u mirembajtur në vazhdimësi.

Në këtë institucion, evidentohen përpjekje për të ruajtur sigurinë e të dhënave individuale në çdo kompjuter, por përgjithësisht është lënë në dorë të individëve për të vendosur fjalekalim, si mjet për parandalimin e hyrjeve të paautorizuara. Gjithashtu, një kontroll i aplikacionit, është edhe mos ndryshimi i informacionit të regjistruar në sistemin ICMIS, mbi të dhënat gjyqësore.

Në gjykate funksionon sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili gjeneron informacion mbi çështjet që nga moment i regjistrimit deri në dhenjen e vendimit të gjykimit. Gjithashtu nga projekti "JUST" i USAID është realizuar instalimi i sistemit audio në sallat e gjyqit, i cili realizon regjistrimin audio të të gjithë seances gjyqësore, në kuadër të transparencës së procesit.

Për sa i përket informacionit financiar, është instaluar programi "Alpha Web", duke filluar nga viti 2016, aktiviteti financiar dhe buxhetor regjistrohet në këtë program. Kjo ka krijuar mundësi për gjenerimin në çdo moment të raporteve të ndryshme përmbledhëse për financën, buxhetin, shpenzimet, personelin etj., duke dhënë një informacion të plotë i cili ka krijuar mundësi e gjykimit mbi realizimin apo progresin e objektivave të njesisë.

Gjykata disponon website e saj për komunikimin e çështjeve gjyqësore, për publikimin direkt nga sistemi i çështjeve që regjistrohen. Gje e cila i mundëson publikut, punonjësve dhe gjykatësve të informohen në kohë mbi oraret dhe specifikat e seancave gjyqësore.

e). Monitorimi

Në gjykatë, monitorimi kryhet nëpërmjet raportimeve periodike të menaxherëve (Kancelares dhe K/D/Buxhetit) tek zv/Kryetaria e Gjykatës. Nëpërmjet raportimeve periodike 4-mujore që gjykata raporton në organin qendror dhe analizave të kryera për fusha të veçanta të veprimtarisë së sektorëve të gjykatës. Në përputhje me afatet ligjore dhe nënligjore në fuqi monitorimi është kryer dhe nga DAB-ja. Për herë të fundit ky monitorim/auditim në këtë institucion është kryer në muajin Tetor të vitit 2019 (*trajtuar në pjesën e zbatimit të rekomandimeve të lëna*).

Opinion i Përgjithshëm për sistemin organizativ : Sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar dhe janë efektiv.

4.3. Sistemi hartimit dhe zbatimit të buxhetit, monitorimi të ardhurave dytësore.

a). Hartimi PBA-ve.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, udhëzimeve përkatëse të M.F. si dhe e udhëzimeve të KLGJ-së, është bërë hartimi, detajimi dhe miratimi i PBA-ve për vitet, 2020-2022 dhe 2021-2023.

Pregatitja e PBA-ve është bazuar në realizimin e shpenzimeve buxhetore të viteve të mëparshme, në strukturën organike dhe numrin e punonjësve, për fondin e pagave dhe sigurimet shoqërore, numrit të çështjeve të gjykuara dhe normativat orientuese për shpenzimet operative, etj.

Treguesit e PBA-ve janë hartuar në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor.

PBA-të përveç detajimit sipas tavanëve kanë parashikuar edhe kërkesat e gjykatës për vitet pasardhëse (1+2).

PBA-të 2020-2022 dhe 2021-2023 pasqyrojnë përmbledhur:

- Planifikimin e shpenzimeve të programit sipas produkteve.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

- Treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tre vitet e ardhshme buxhetore;
- Shpenzimet kapitale, listën e investimeve të pasqyruar me:
 1. Koston e plotë të projekteve
 2. Vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor
- Relacionin shoqërues për kërkesat buxhetore;
- Projektin e planit të arkës vjetor dhe të detajuar në muaj, i cili përfshin:
 1. Fluksin e të ardhurave të parashikuara për t'u mbledhur dhe arkëtime të tjera
 2. Planin e prokurimeve
 3. Pagesat e parashikuara që rrjedhin nga angazhimet.

Në hartimin e PBA-ve është respektuar procedura në zbatim të UMF nr.7 datë 28/02/2018 "Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" të cilat janë të dokumentuara. Pasqyrat e PBA-ve janë plotësuar sipas standarteve të M.F e janë shoqëruar me relacionet shpjeguese dhe janë dërguar në afat në KLGJ.

PBA-të janë miratuar nga EMP i njësisë qendrore(KLGJ) por nuk janë regjistruar në programin financiar.

b).Zbatimi i Buxhetit

Zbatimi i buxhetit është kryer në referencë të Ligjit Nr. 9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Ligjeve vjetore të zbatimit buxhetit, udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe udhëzimeve vjetore të M.Financave.

Gjykata ka kryer detajimin fillestar të fondeve të buxhetit(*planin e arkës*) sipas muajve i ka depozituar në degën e thesarit, i ka pasqyruar ato në program dhe ka bërë kontabilizimin e tyre.

Ndryshimet në buxhetin fillestar të ndodhura gjatë vitit janë pasqyruar në momentin e ndodhjes së tyre dhe në fund të cdo viti është paraqitur buxheti përfundimtar si në kontabilitet dhe në situacionet vjetore të shpenzimeve dhe pagesave. Për transferimet e fondeve nga njëri artikull në tjetrin është respektuar udhëzimi standard nr .9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar dhe udhëzimet plotësuese vjetore të M.F.

Buxhetet fillestare dhe ndryshimet e pësuara gjatë vitit paraqiten si vijon:

Në mijë leke

Art	Pershkrimi	2019			2020				
		Buxheti Fillestar	Ndryshime		Buxheti Final	Buxheti Fillestar	Ndryshime		Buxheti Final
			Shtesa	Pakësime			Shtesa	Pakësime	
600	Shpenzime per paga	45,450	12,810		58,260	65,000		6,650	58,350
601	Shpenzime per SSHSH	7,000			7,000	7,000		400	6,600
602	Shpenzime mallra e sherbime	13,000		600	12,400	11,000	44		11,044
606	transferata te Familjet & Individidet		134		134.0		37.5		37.5
230	Shpenzime per AAGJ JM	0			0	140			140
231	Shpenzime per AAGJ M	1,810			1,810	4,250			4,250
Shuma:		67,260	12,944	600	79,604	87,390	82	7,050	80,422

Buxheti ka patur ndryshime në shtesa e pakësime për gjithë periudhën e audituar. Për vitin 2019 buxheti fillestar ka pësuar ndryshime me shtesë fondesh në artikullin, 600 për shkak të fillimit të aplikimit të pagave të reja për gjyqtarët sipas ligjit 96/2016.

Të dhënat e realizimit në total(*Fondet e buxhetit dhe të Ardhurat*) të zërave kryesorë të buxhetit paraqiten si më poshte:

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Ne 000/leke

Nr.Llog Ekonom	Pershkrimi	Plan 2019			Realizimi		Plan 2020			Realizimi	
		Te Ardh	Buxheti	Total	Fakti	Real. ne %	Te Ardh	Buxheti	Total	Fakti	Real. ne %
230	Shpenzime per AAGJ JM		0					140	140	118	84
231	Shpenzime per AAGJ M	120	1,810	1,930	1,367	71	200	4,250	4,450	4,161	94
600	Shpenzime per paga		58,260	58,260	58,211	100		58,350	58,350	58,321	100
601	Shpenzime per SSSH		7,000	7,000	6,620	95		6,600	6,600	6,551	99
602	Shpenzime mallra e sherbime	1,200	12,400	13,600	13,284	98	800	11,044	11,844	11,463	97
606	transferta te Familjet & Individet		134	134	134	100		38	38	38	100
	Shuma	1,320	79,604	80,924	79,617	98	1,000	80,422	81,422	80,652	99

Realizimi i buxhetit vjetor është në masën 98-99%.

Investimet e planifikuara janë realizuar në masën 71% për vitin 2019, dhe 84-94% për vitin 2020.

Mosrealizimi në investime vjen si rrjedhojë e konkurrencës së operatorëve ekonomikë pasi gjykata ka realizuar të gjitha prokurimet e programuara që lidhen me investimet.

Të ardhurat dytësore të realizuara janë përdorur për investime dhe shpenzime operative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Realizimi dhe përdorimi i të ardhurave dytësore janë pasqyrura në situacionet progresive mujore dhe vjetore dhe janë raportuar në pasqyrat financiare vjetore.

Situacionet mujore dhe progresive të shpenzimeve janë rakorduar me degën e thesarit dhe janë të nënshkruara prej tyre.

Opinion i përgjithshëm: Sistemi kontrollit të brendshëm në hartimin dhe zbatimin e buxhetit ka funksionuar mirë.

c). Të ardhurat (jashtë limitit/dytësore)

Në zbatim të Ligjit Nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombetare" i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët nr.33 datë 29/12/2014 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë" dhe në reference edhe të Kodit të Procedurës Civile 160/2013 i ndryshuar me ligjin 38/2017, Kreu IV, nenet 102-110 u realizua auditimi i të ardhurave nga shërbimet gjyqësore.

U audituan me zgjedhje dosjet e çështjeve civile për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12. 2020 për saktësinë e përlogaritjes së tarifës gjyqësore, arkëtimin e saj dhe të shpenzimeve të tjera gjyqësore.

Në kampionin e përzgjedhur prej 250 dosje të vendimuar e të arshivuara konstatohet tarifa gjyqësore është përlogaritur në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët nr.33 datë 29/12/2014 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë" shtojca nr.1.

Nga dega e buxhetit janë kryer regjistrime kontabile jo analitike për të ardhurat e realizuara nga tarifa gjyqësore.

Masa e përfitimit, taksa gjyqësore prej 10% është llogaritur dhe kontabilizuar dhe përdorur nga gjykata nëpërmjet rritjes së autorizimeve me miratim nga dega e thesarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Të ardhurat e realizuara për çdo muaj janë deklaruar në sistemin tatimor nëpërmjet formularit të deklarimit brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.33 datë 29.12.2014 dhe janë derdhur në favor të buxhetit të shtetit në llogaritë përkatëse të sistemit thesarit.

Për të ardhurat e realizuara nga tarifa gjyqësore dhe shërbimet e tjera gjyqësore janë kryer rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit dhe janë pasqyruar edhe në situacionet mujore dhe vjetore.

Të ardhurat që i përkasin gjykatës dhe të papërdorura deri më 31/12/2020 janë transferuar në buxhetin e shtetit.

Opinion i përgjithshëm: Sistemi i kontrollit të brendshëm për tarifatat gjyqësore dhe shpenzimet e tjera gjyqësore funksionon mirë.

4.4. Sistemi i i Pagesave (Pagat, Shpenzimet e funksionimit dhe shpenzimet e tjera)

4.4.1. Pagat dhe shtesat që lidhen me to

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse procedurat e pagesave janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, si dhe nëse janë të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës, vërtetues e justifikues.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Përputhja e numrit të punonjesve me strukturën organizative të miratuar sipas urdhërave përkatës.
- Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës, elementët e shtesave mbi page, përputhshmëria ligjore për çdo shtesë, saktësia e llogaritjes së tyre si dhe ndalesat mbi paga.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për pagat jashtë orarit, dhe në ditë pushimi e festa zyrtare.
- Përputhshmëria për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale, sigurimit suplementar, si dhe derdhja e tyre në llogaritë përkatëse.
- Respektimi i dispozitave ligjore mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.

a) Struktura dhe niveli i pagave të punonjësve, shtesat mbi page dhe ndalesat nga paga.

Për auditimin e sistemit të pagave u përdor metoda me zgjedhje, metoda e testimit hap pas hapi me teknik të auditimit me përzgjedhje nga listë prezencat në listë pagesat e punonjësve, pasqyrimin e tyre në librin e pagave si dhe rakordimi i pagës neto me shumën e hedhur në llogarinë bankare, përlllogaritja e vjetërsisë bazuar ne librezat e punës me pasqyrimin e bëre nga kancelarja si personi përgjegjës për burimet njerëzore dhe shtesa e dhene referuar listepagesave, për secilin punonjës. Kampioni i përzgjedhur për auditim: (listëpagesat e muajt, qershor, tetor, nëntor 2019, dhe shtator, tetor, nëntor 2020).

Për periudhën e audituar sistemi i pagave në Gjykatë, për trupën gjyqësore është bazuar ne Ligjin Nr.96/2016 “Për Statusin Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, ndryshuar me VKM nr.202, datë 15.03.2017 dhe VKM nr.187, datë 08.03.2017, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit të KLGJ nr.38 datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore për pagat dhe shtesat mbi pagë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë për testim rezulton se :

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

-Është repektuar struktura dhe niveli i pagave të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

-Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pagës për vjetërsi në shërbim për trupën gjyqësore dhe vjetërsisë në punë të punonjësve administrativ, (*kampioni për 20 punonjës*) rezulton se:

-Shtesa e pagës për vjetërsi për trupën gjyqësore është kryer në bazë të shkresës nr.784/1 datë 13.02.2019, të KLGJ-së për vjetërsinë e trupës gjyqësore referuar regjistrin të gjyqtareve.

-Llogaritjet për pagesën e shtesës së pagës për vjetërsi në punë të punonjësve administrative janë kryer referuar librezave të punës. Nga krahasimi i viteve të punës në librezë me përlllogaritjet e kryera për shtesë page për efekt të vjetërsisë në punë referuar listepagesave nuk rezultuan diferenca.

Ndryshimet për efekt të rritjes së vjetërsisë në punë si për trupën gjyqësore dhe për administratën janë kryer nga kancelarja, janë miratuar rast pas rasti nga titullari dhe dërguar në zyrën e financës për të kryer përlllogaritjet për efekt pagese.

-Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pagës për "*Për natyrë të veçantë pune*", rezultoi se: Paga ka filluar mbas marrjes të miratimeve përkatëse nga DAP-i, shkresa nr.1043/2 datë 15.04.2016, kjo shtesë përfitohet nga specialistja e IT .

- Në lidhje me pagesat e kryera për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar rezulton se: vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar është llogaritur dhe paguar në përputhje me VKM nr.524, date 16.08.2012, lidhja 2, i ndryshuar, dhe VKM nr.187 datë 01.03.2017.

- Për pagesën e shtesës të pagës për vështirësi e dëmshmëri në punë për pozicionet e punës: *nëpunës gjyqësor/ftus, sanitare*, në zbatim të rekomandimit të lënë në auditimin e mëparshëm gjykata ka ndërprere dhënien e kësaj pagese me urdhërin e dates 02.12.20219, të zv/kryetares së gjykatës, dhe marrë miratimet nga institucionet përkatëse konfirmuar nga KLGJ me shkresën nr.4789/1 datë 08.10.2020, "*Mbi miratimin e shkallës së vështirësisë në punë*", (trajtuar në pikën 1,zbatimi i rekomandimeve të lëna).

-Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës, nga auditimi rezulton se: është zbatuar kategoria e pagave për administratën mbështetëse sipas VKM nr.202, datë 15.03.2017.

b). Hartimi i listepagesave dhe listëprezencave:

-Prezenca në punë e punonjësve është e dokumentuar me përpilimin e dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë, me listëprezencë.

Listëprezencat janë mbajtur nga kancelarja e gjykatës në cilësin e menaxherit në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011"*Për Menaxhimin e Aktiveve ne NJSP*" kreu III-të paragrafi "*Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë*", pika 69 dhe 71. kap. V.

Listë pagesat janë hartuar dhe nëshkruar nga k/d/buxhetit në cilësin e nëpunësit zbatues, nga Zv/Kryetari i Gjykatës/nëpunësi autorizues si dhe të konfirmuara nga Dega e Thesarit në të gjitha rastet e kampionit të marrë për auditim , në përputhje me nenin 22, pika 3(c) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2000, "*Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin*", i ndryshuar, është respektuar *sistemi i dy nënshkrimeve*.

-Nga krahasimi i numrit të ditëve të pasqyruara në listëprezencë me numrin e ditëve në listëpagesë nuk rezultuan diferenca.

- Nga testimi mbi përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara në bankë sipas punonjësve me pagën neto në listëpagesë , rezulton se: paga neto e pasqyruar në listëpagesë është e njëjtë me pagën neto të pasqyruar në llogarinë personale sipas formatit të listëpagesës së bankës. Pagat e personelit janë pasqyruar në librin e pagave.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

c). *Zbatimi i dispozitave ligjore për punën e kryer jashtë orari në ditë pushimi e festa zyrtare.*

- Nga sondazhet e kryera në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e orëve jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare, rezultojnë se pagesat e trupës gjyqësore janë kryer në zbatim të udhëzimit të KLGJ nr.38 datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”.

Puna e kryer nga administrata gjyqësore në ditë pushimi e festa zyrtare është kompensuar financiarisht deri në muajin tetor 2019, në zbatim të rekomandimit të lënë në auditimin e mëparshëm: *citoj(Të ndërpritet pagesa e orëve jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare, për punojësit e administratës gjyqësore. Oret e punës që do të kryhen jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare të kompensohen me pushim)*, me urdhërin nr.534, datë 01.10.2021, të Zv/kryetares së gjykatës, për ndërprerjen e kompensimit financiar për punën e kryer nga administrata gjyqësore në ditë pushimi e festa zyrtare kompensimi do të jetë me pushim, rekomandim i zbatuar (*trajtuar në pika, zbatimi i rekomandimeve*).

d) *Përputhshmëria për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale si dhe derdhja e tyre në llogaritë përkatëse, sigurimi suplementar.*

Për periudhën nën auditim rezultojnë se; llogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi pagat dhe të ardhurat personale, është kryer në zbatim të legjislacionit në fuqi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore dhe janë derdhur në Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas afateve të përcaktuara ligjore. Llogaritjet janë kryer për çdo punonjës, janë ndaluar nga paga sigurimet Shoqërore e Shëndetësore duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën.

Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen, ndalesën dhe xhirimin e sigurimit suplementar të detyrueshëm për trupën gjyqësore për llogari të Sigurimeve Shoqërore rezultoi se: nuk janë reflektuar ndryshimet nga 3% në 4% , që rrjedhin me hyrjen në fuqi të ligjit 96/2016, në zbatim të nenit 21, pika 1, prej 01.01.2019, ky konstatim i grupit të auditimit u reflektua gjatë periudhës së auditimit ku me urdhërin e Zv/kryetares së gjykatës nr.273.prot, datë 31.05.2021, urdhërohet zyra e buxhetit për kryerjen e sistemeve për ndryshimet në përlllogaritjen e sigurimit suplementar nga 01.01.2019 e në vijim në zbatim të kushteve të reja ligjore. Auditimi nuk e sheh të arsyeshme lënien e këtij rekomandimi pasi procedura e sistemit filloj gjatë periudhës së auditimit. Për shkak të ndryshimeve në ligjin 96/2016, duhet kushtuar vëmendje nga dega e buxhetit për pasqyrimin në kohë të ndryshimeve në sistemin e pagave.

e). *Respektimi i dispozitave ligjore mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.*

Nga auditimi rezultojnë se fondi i veçantë për periudhën nën auditim është përdorur në dy raste për dalje në pension, një rast për fatkeqësi familjare. Nga ana e gjykatës janë marrë miratimet përkatëse në konformitet me dispozitat ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.

Opinion i përgjithshëm për sistemin e pagave: Kontrolli i brendshëm në sistemin e pagave ka funksionuar dhe është efektiv. Risku vlerësohet i ulët.

4.4.2. Shpenzimet e funksionimit dhe shpenzime të tjera.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse veprimet e kryera për pagesat gjatë periudhës objekt auditimi kanë mbështetje ligjore dhe janë të mbështetura në dokumentacionin justifikues.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

-Respektimi i gjurmës së auditit për ngjarjet ekonomike dhe transaksionet.

Dokumentimi dhe mbështetja me dokumentacionin përkates justifikues të pagesave për blerje të mallrave të investimeve apo të shërbimeve në përputhje me UMF nr.9 datë 20/03/2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, legjislacionin në fuqi dhe gjurmën e auditit të miratuar në këtë udhëzim.

-Shpenzimet për shërbim postar, energji, uje, telefon, mirmbajtje të aktiveve të qëndrueshme (ndërtesa, autovetura, kaldaj, gjenerator etj).

-Shpenzimet për avokat kryesisht, ekspert, përkthyes, psikologë etj.

-Vendosja e normativave të konsumit të materialeve, në veçanti për karburantin dhe monitorimi i vazhdueshëm i tyre (kartelat, flet udhëtimet, urdhër dorzimet, plan shpërndarje etj).

a). Respektimi i gjurmës së auditit për ngjarjet ekonomike dhe transaksionet.

Transaksionet konsistojnë kryesisht për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të tretë, për pagesat e pagave të punonjësve dhe pagesat e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat që rrjedhin nga pagat si dhe derdhjet në buxhet të të ardhurave jashtë limitit (*tarifa e shërbimit gjyqësor, etj*) të cilat bëjnë të mundur realizimin e funksionimit normal të aktivitetit të gjykatës dhe arritjen e objektivave të parashikuara.

Me zgjedhje u auditua dokumentacioni i urdhër shpenzimeve/pagesave për blerjet e mallrave e shërbimeve, investimeve, pagesat e pagave dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre, si vijon; (*për vitin 2019 me 66 U.Shpenzime, për vitin 2020 me 68 U.Shpenzime*) të kryera ndaj operatorëve ekonomikë me të cilët gjykata ka krijuar marrëdhënie blerje mallrash apo shërbimesh.

Kampioni i përzgjedhur konsiderohet i mjaftueshëm dhe i lejon auditit nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në lidhje me sigurinë e arsyeshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marre për testim rezulton se:

- Urdhër shpenzimet janë të nënshkruara nga N.Autorizues dhe N.Zbatues (*sistemi i dy nëshkrimeve*).

-Çdo urdhër shpenzim ka bashkëlidhur (*dokumentacionin autorizues*); urdhër prokurimi, urdhër blerje, (*sipas rastit*), kopje të kontratave të lidhura, (*dokumentacionin vërtetues*); faturën e blerjes, procesverbalin e marrjes në dorëzim, listëprezencat dhe listpagesat e punonjësve, etj .

- Urdhër shpenzimet janë kronologjike dhe nuk ka kapërcime të numrit rendor .

- Nga krahasimi i çmimeve në kontratat e lidhura, në blerjet me vlera të vogla me faturat e lëshuara nga operatorët ekonomikë si dhe flethyryeve të magazinës rezulton se janë të barabarta.

- Nga kontrolli aritmetik i vlerave të dokumentacionit vërtetues (*Fatura Blerje, F.Hyrje, Sit.Shpenzimi, listpagesa*) me vlerat në urdhër shpenzim dhe regjistrimet në kontabilitet (*Ditarin e Bankës*) rezulton se ato janë të barabarta dhe të pasqyruara saktë.

- Urdhër shpenzimet për transferimin e të ardhurave në buxhet kanë bashkëlidhur deklaratat mujore të printuara nga sistemi tatimor.

- Dokumentacioni shoqëruar i çdo transaksioni është miratuar nga Dega e Thesarit dhe është konfirmuar me nënshkrimin e punonjësit dhe vulosjen me vulën e thesarit.

- nga auditimi mbi respektimin e afatit 30 ditor të pagesave, në tre raste u konstatuan pagesa të likujduara jashtë afatit, (*U.Sh.nr.155, datë 13.08.2020, likujduar fatura nr.321877500, datë*

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

03.07.2020, U.Sh.nr.156, datë 13.08.2020, likujduar fatura nr.338, datë 30.06.2020, U.Sh.nr 157, datë 13.08.2020, likujduar fatura nr.23, datë 09.07.2020), nga intervista me k/d/buxhetit na u pohua se vonesa ka ardhur si pasojë e karantinimit për shkak të infektimit me virusin Covid-19, (vërtetuar me vërtetimin e mjekut datë 03.08.2020).

b).Shpenzimet e funksionimit dhe shpenzime të tjera

Për arritjen e objektivave gjykata si njësi shpenzuese kryen funksionin e saj nëpërmjet përdorimit të fondeve buxhetore dhe pjesërisht nga të ardhurat jashtë limitit (pjesa takuese në masën 10%) në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përzgjedhjen e kampionit për auditimin e shpenzimeve (art.602) u vlerësua risku i shpenzimit dhe pesha specifike që zënë zërat e shpenzimeve në totalin e tyre për periudhën nën auditim.

Shpenzimet e kryera dhe pesha në përqindje për periudhën objekt auditimi paraqitet:

Art.	Emertimi	viti 2019		viti 2020		Mesatarja/ periudhën
		në lekë	në %	në lekë	në %	
6020	MATERIALE E SHËRBIME ZYRE	852,138	7	1,598,372	14.9	10.7
6022	SHËRBIME	7,475,865	62	6,082,255	57	59.4
6023	SHPENZIME TRANSPORTI	570,407	4.7	101,459	0.6	2.9
6024	SHPENZIME UDHETIMI	91,000	0.8	59,000	0.6	0.7
6025	SHPENZ.MIRMBAJTJE ZAK.	565,400	4.7	362,400	3.4	4.1
6029	SHPENZ. TE TJERA OPERATIVE	2,572,223	21	2,495,500	23.3	22.2
602	Shuma	12,127,033	100	10,698,986	100	100

Të dhënat u morën nga situacionet e shpenzimeve buxhetore vjetore 2019, 2020

Nga auditimi rezulton se shpenzimet në artikullin “Shërbime ” zënë peshën më të madhe në masën 59.4 % (energji elektrike, ujë, telefon, shërbim postar), shpenzime të tjera operative zënë 22.2%(shpenzime per ruajtje godine, shpenzime për avokatë,etj), materiale shërbime zyre në masën 10.7 % .

Shpenzimet postare zënë peshën më të madhe të shpenzimeve operative për periudhën objekt auditimi, nga ana e gjykatës lidhur me këto shpenzime është mbajtur akt rakordimi në mënyrë sistematike ndërmjet rregjistrimit postar të operatorit ekonomik dhe rregjistrimit postar të mbajtur në gjykatë. Pas kryerjes së rakordimeve është konfirmuar fatura e operatorit ekonomik Posta Sh.A, dhe është kryer pagesa brenda afateve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Nga ana e gjykatës nuk ka një akt të brendshëm një procedure në lidhje me mënyrën e kryerjes së njoftimeve, mënyrën e vjeljes së shpenzimeve të njoftimit (rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm trajtuar në pikën 1,zbatimi i rekomandimeve).

Nga auditimi i shpenzimeve për pagesat e avokatëve të thirrur kryesisht, konstatohet se ato janë kryer bazuar në Urdhërin Nr. 1284/3 datë 16.03.2005 të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Për shërbimin e kryer avokatët kanë paraqitur pranë gjykatës faturën tatimore e shoqëruar me vërtetimet e lëshuara nga gjykata të cilat janë të konfirmuara nga gjyqtari i çështjes, sekretarja gjyqësore dhe kancelarja.

Nga auditimi për shpenzimet e kryera për pagesat e eksperteve, psikologëve konstatohet se ato janë kryer në përputhje me udhëzimin e K.M nr. 4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

Nga auditimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë, janë kryer sipas faturimit mujor nga ana e operatorëve ekonomikë për këto shërbime dhe nuk ka detyrime të prapambetura.

Shpenzimet për telefon, internet, janë kryer sipas faturimit mujor nga ana e operatorëve ekonomikë për këto shërbime. Nga auditimi konstatohet se në zbatim të rekomandimit të lënë në lidhje me mbajtjen e

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

numrave të telefonit të panevojshmem citoj: *(GMS(grupi menaxhimit strategjik) te trajtoje nevojen e mbajtjes se numrave telefonike fiks dhe per numrat te cilet jane te panevojshem te kerkoje nderprerjen e kontrates me operatorin ekonomik me qellim eleminimimin e shpenzimeve te panevojshem dhe perdorimin me eficence e dobi te burimeve financiare).*

Gjykata me shkresen nr.9461 prot. datë 19.11.2019, drejtuar kompanise Albtelecom sha, e cila ka bërë shkëputjen e 4 numrave te telefonise fikse. Janë lënë ne funksion vetem 2 numra fiks, 1 për komunikim per institucionin dhe 1 për internetin.

Shpenzimet e kryera per mirmbajtje godine, gjenerator, autovetura etj, janë kryer me procedurë prokurimi trajtuar ne sistemin e prokurimeve.

Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime e dieta konstatohet se këto shpenzime janë në përputhje me VKM-në nr.997, datë 10.12.2010, “ për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendres së punës, brenda vendit” i ndryshuar me VKM nr.329, date 20.04.2016, ndryshuar me VKM nr.130, date 07.03.2018, punonjësit janë autorizuar rast pas rasti nga titullari i institucionit ku është përcaktuar koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

c).Procedurat e ndjekura për materialet e konsumueshme, konsumi i karburantit monitorimi i tij.

Artikujt e blerë nga gjykata për periudhën objekt auditimi janë bërë hyrje në magazinë me F.Hyrjet të cilat janë prerë mbi bazën e faturës së blerjes të lëshuara nga operatorët ekonomik. Në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27/11/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NJSP”, materialet e konsumueshme janë bërë dalje nga magazina mbi bazën e urdhër-dorzimeve të lëshuara nga kancelarja ku janë të përcaktuara sasia dhe data e furnizimit dhe janë nënshkruar nga marrësi dhe magazinjeri.

Pajisjet dhe materialet e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale të nënshkruara prej tyre.

F.Hyrjet dhe F.Daljet janë prerë manualisht janë konfirmuar nga personat përgjegjes dhe janë pjesë e dokumentacionit kontabël.

- Mbi rregullshmërinë e administrimit dhe konsumit të karburanteve:

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e mbajtjes të dokumentacionit për administrimin e karburantit dhe respektimin e rregullave për evidentimin e karburantit të shpenzuar, rezulton se :

Administrimi i karburantit për periudhën objekt auditimi është bërë me dokumentacion të mbajtur nëpërmjet magazinës dhe kancelares si personi i autorizuar për menaxhimin e sistemit elektronik të furnizimit me karburant , për sasinë e blerë dhe bërë hyrje si dhe për sasi të shpërndarë dhe tërhequra në mënyrë periodike gjatë vitit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se gjykata ka përdorur dhe konsumuar karburant të llojit naftë dhe benzinë për dy automjete në pronësi të gjykatës *(për automjetin opel astra me targa AA208SG është përdorur benzinë, dhe automjeti Alfa romeo me targa AA795SG është përdorur naftë).*

Konsumi i karburantit është monitoruar mbi bazën e km. të përshkruara, normativës së konsumit të miratuar, flet udhëtimeve mujore të çdo automjeti.

Flet udhëtimet janë mbajtur për çdo automjet, janë të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe nga shoferi/përdoruesi i automjetit në të gjitha rastet.

Për çdo muaj janë përlllogaritur kilometrat totale të përshkuara dhe konsumi i karburantit në total mbështetur në normativen e harxhimit nga automjetet për 100 km.

Për çdo lëvizje të automjeteve jashtë rrethi janë autorizuar dhe miratuar destinacionet e lëvizjeve dhe arsyeja e lëvizjes, furnizimi me karburant është kryer në bazë të urdhër dorzimit të lëshuar nga kancelarja.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Njëkohësisht u auditua menaxhimi i shpenzimeve të karburantit nëpërmjet sistemit elektronik në zbatim të VKM nr 561 dt.27.7.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme” i ndryshuar me VKM nr.344, datë 12.06.2018.

Sistemi elektronik i furnizimit me karburant për periudhën nën auditim është administruar nga kancelarja në zbatim të Urdhërit nr.5379, datë 27.11.2019, të Zv/kryetares së gjykatës “Për Menaxhimin e sistemit Elektronik të Karburantit”.

Automjetet janë të pajisura me karta elektronike të personalizuar referuar targave të tyre (*shkresa nr. 27/1, datë 27.11.2019 i operatorit ekonomik olsi sh.p.k, dorëzim tollonë elektronikë*) me të cilin gjykata ka lidhur kontratën për furnizimin me karburant.

Veprimet e furnizimit me kartë elektronike nga përdoruesit e automjeteve janë shoqëruar me kupon tatimor për furnizimin e kryer nga operatori ekonomik për secilin automjet, F.Daljet e prera nga magazina kanë bashkëlidhur këtë dokument vërtetues.

Referuar gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm gjykata ka reaguar në drejtim të kryerjes së veprimeve korrigjuese ndaj rekomandimeve të lëna si dhe ngritjes së sistemit të monitorimit të karburantit (*trajtuar në pikën 1, zbatimin e rekomandimeve*).

Gjykata ka në inventar një gjenerator i cili përdoret në rastet e shkëputjes së energjisë elektrike. Në rastet e vënies në punë të gjeneratorit është mbajtur proces verbal ku pasqyrohet koha e vënies në punë.

-Referuar sa më lart auditin arrin në konkluzionin se në gjykatë është krijuar dhe ka funksionuar sistemi për administrimin e karburantit dhe monitorimin e konsumit të tij, është mbajtur dokumentacioni i rregullt mbështetës, justifikues dhe vërtetues.

Opinion i Përgjithshëm për sistemin e pagesave: Sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar dhe janë efektiv, vlerësohet me rrisht të ulët.

4.5. Sistemi i raportimit financiar publik (organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, hartimi i pasqyrave financiare vjetore)

4.5.1. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit

Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare për periudhën e audituar është realizuar në programin financiar alpha web i cili gjeneron të dhëna në përputhje me standartet e pranuar të kontabilitetit në sektorin publik të miratuara nga KKK.

Nga auditimi i llogarive kontabël konstatohet se regjistrimet e kryera janë bazuar në dokumentacionin origjinal të blerjeve dhe dokumentacionit justifikues të tyre.

Vlerat e regjistruara të veprimeve ekonomiko financiare dhe transaksionet e lidhura me to janë të sakta e të besueshme. U krye kryqëzimi i dokumentacionit të blerjeve, hyrjeve në magazinë dhe pagesat e realizuara për to nga ku konstatohen se vlerat e tyre janë të barabarta, në dokumentacionin vërtetues (*faturë blerje malli/shërbimi, flet hyrjet e magazines, listpagesa, etj*).

Titulli i gjetjes: Regjistrimi i dokumentacionit bazë në librat e kontabilitetit.

Nr.gjetjes 1	
Subjekti audituar	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none">▪ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier▪ Këshilli i Lartë Gjyqësor
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

	<p>menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit M.F.E. nr.8 datë 09/03/2018“<i>“Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme“</i>.</p> <p>Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NJSP” i ndryshuar.</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Regjistrimet e faturave të blerjes ne kontabilitet nuk janë kryer sipas ekstremiteteve të tyre(<i>nr të faturës</i>) por për numër është vendosur numri i urdhër shpenzimit. Njëkohësisht flet hyrja e magazinës e regjistruar në kontabilitet nuk mban të njëjtin nr me faturën bashkëlidhur urdhër shpenzimit e cila është prerë manualisht dhe jo nëpërmjet programit elektronik ku mbahet kontabiliteti i gjykatës.</p> <p>Kriteri: Respektimi i procedurave për kontabilizimin e plotë të vërtetë, të saktë dhe në kohën e duhur të ngjarjeve ekonomike.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i vërtetë i të dhënave të dokumentacionit vërtetues të blerjeve të aktiveve(<i>në veçanti të aktiveve afatgjata</i>) apo shërbimeve.</p> <p>Shkaku: Mosnjohje e mirë e legjislacionit përkatës</p>
Vlerësimi i nivelit të rrishtut(i lartë, i mesëm, i ulët)	Rrisk i mesëm
Konkluzioni	Funksionim jo efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm.
Rekomandimi nr.1	Regjistrimet në librat kontabël të dokumentacionit të blerjeve të kryhet duke evidentuar me vërtetësi ngjarjen ekonomike të ndodhur(<i>blerjen e aktiveve apo shërbimit</i>) dhe hyrja e aktiveve duhet të shoqërohet me Flet-Hyrjen e regjistruar në kontabilitet.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë
Statusi i rekomandimit	

Ngjarjet ekonomike të ndodhura janë të rregjistruara në llogari dhe nuk u konstatuan ngjarje ekonomike të pa regjistruara.

Ngjarjet ekonomike janë kryer në kohën e ndodhjes së tyre dhe në mënyrë kronologjike duke respektuar parimin rritës.

Për veprimet ekonomike - financiare të kryera janë realizuar akt-rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit. Akt-rakordimet janë të nënshkruar nga dega e thesarit dhe K/D/Buxhetit të gjykatës.

Nga auditimi i veprimeve të arkës konstatohet se kryerja e veprimeve në *Cash* vjen nga arkëtimi i tarifës gjyqësore nëpërmjet pullave, nga tarifa e njoftimit të palëve e shërbimeve të tjera që kryen administrata gjyqësore. Veprimet e arkës janë kryer në përputhje me udhëzimin nr.30 datë 27/12/2011“Për menaxhimin e aktiveve në NJSP“ i ndryshuar.

Nga testimi i vlerave të aktiveve dhe pasiveve dhe llogarive analitike të tyre konstatohet se ato pasqyrojnë gjendjen reale dhe të besueshme të kapitaleve të gjykatës.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Asetet janë të regjistruara në emër të gjykatës mbi bazën e dokumentacionit vertetues dhe justifikues. U auditua ndryshimi i gjendjes së aktiveve (*shtesa dhe pakësime*) dhe konstatohet se shtesat e aktiveve kanë ardhur nga blerjet, ndërsa pakësimet kanë ardhur nga nxjerrjet jashtë përdorimit.

U audituan pakësimet e aktiveve dhe dokumentacioni që shoqëron veprimet kontable të kryera.

Pakësimi i aktiveve nga nxjerrja jashtë përdorimi është kryer në zbatim të udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP" i ndryshuar.

Nxjerrjet jashtë përdorimit janë regjistruar në kontabilitet me flet daljen e magazinës.

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur mbi bazën e normave të amortizimit të përcaktuara në udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme".

Inventarizimi i përgjithshëm aktiveve

Për periudhën nën auditim, për çdo vit është realizuar inventarizimi i përgjithshëm i aktiveve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhim financiar dhe kontrollin" të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP" i ndryshuar , pikës 73 dhe 74.

U audituan procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimeve të përgjithshme për vitet 2019 dhe 2020 konstatohet se janë respektuar procedurat e inventarizimit të përcaktuara në udhëzimin nr.30 datë 27/12/2011 të ndryshuar.

Për kryerjen e inventarizimeve të përgjithshme është ngritur komisioni i inventarizimit me urdhër të brendshëm të zv/kryetares të gjykatës (U.Br.nr.692 dt.16/12/2019 dhe U.Br.nr.654 dt.14/12/2020)

Komisioni i inventarizimit dhe punonjësit e tjerë që kanë përgjegjësi në procesin e inventarizimi kanë respektuar procedurat sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 i ndryshuar edhe në mungesë të gjurmës së auditimit për kryerjen e inventarizimit. Si mangësi konstatohet mosdeklarimi i konfliktit të interesit të antarëve të komisionit të inventarizimit dhe disa mangësi në paraqitjen formale të dokumentacionit (*raportit të inventarizimit që është paraqitur si procesverbal*) por që nuk kanë cënuar procesin dhe si të tilla u vlerësua të mos trajtohen si gjetje.

Në përfundim rezultatet e inventarizimit janë miratuar nga NA. Nga kryerja e inventarizimeve nuk janë konstatuar mungesa apo teprica. Aktivitetet e konstatuara për vlerësim nga komisioni i inventarizimit janë evidentuar dhe raportuar N.Autorizues.

2. Hartimi i Pasqyrave Financiare

Auditimi i pasqyrave financiare për periudhën e audituar u përqëndrua në treguesit kryesor të tyre dhe në :

- Vlerësimin se raportet financiare janë të mbështetura në të dhënat e llogarisë
- Vlerësimin e zbatimit të parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore.
- Vlerësimin e procedurave të mbylljes së llogarive
- Respektimi i formatit standart të miratuar
- Respektimit të afateve ligjore të përgatitjes e dorëzimit të bilanceve vjetore.
- Pasqyrat shoqësuese dhe të dhënat e tyre.
- Relacionet shpjeguese, etj.
- Respektimi i parimit të vijimësisë (*përputhja e vlerave të posteve / llogarive në çelje të vitit të ri ushtrimor me vlerat në mbyllje të vitit të mëparshëm ushtrimor*).
- Miratimi i pasqyrave financiare

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Hartimi i pasqyrave financiare është kryer sipas kërkesave të SKK, të Ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, ligjit nr 9936 datë 26/06/2008 , “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012, ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016 dhe ligjit 10296 datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Raportet financiare janë mbështetur në të dhënat e librave të llogarisë. Nga krahasimi i gjendjeve të llogarive në fund të vitit me ato në pasqyrat financiare rezulton se ato janë të barabarta.

Pasqyrat financiare kanë respektuar parimet e përgjithshme të përgatitjes së tyre

Pasqyrat financiare kanë shkresat përcjellëse për depozitmin në degën e thesarit dhe KLGJ dhe janë dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve sipas programit të cilët janë të rakorduara me degën e thesarit Tiranë.

Vlerat e posteve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar janë të barabarta me vlerat e posteve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të printuar nga SIFQ e cila është nënshkruar dhe vulosur nga nëpunësi thesarit.

Vlerat e posteve/llogarive në çelje të vitit ushtrimor janë të barabarta me vlerat në mbyllje të vitit ushtrimor paraardhës në zbatim të SKK dhe parimit të vijimësisë në vlerësimin e AAGJ.

1.1. Auditimi pasqyrave të pozicionit financiar

a) Aktivet afat shkurtra

Për periudhën e audituar aktivet afatshkurtra në mbyllje të vitit ushtrimor përkatës paraqiten me gjendjet si vijon:

Në lekë

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Viti 2020	Viti 2019
I	Aktivt Afatshkurtra	12,909,038	11,654,837
	1. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5,788,091	4,664,963
520	Disponibilitete ne thesar	4,782,091	3,652,963
532	Vlera te tjera	1,006,000	1,012,000
	2. Gjendje Inventari qarkullues	1,302,346	1,347,175
31	Materiale	562,734	739,023
32	Inventar i imet	739,612	608,152
	3. Llogari te Arketueshme	5,818,601	5,642,699
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	5,818,601	5,642,699
	4. Te tjera aktive afatshkurtra	0	0

Logaria 520 paraqet gjendjen e mjeteve monetare në 31/12 dhe përfaqëson mjetet monetare nga arkëtimi i tarifës së shërbimit gjyqësor e cila i derdhet buxhetit në janar të vitit pasardhës, garancitë e punimeve dhe garancitë pasurore. Këto vlera përputhen me akt rakordimin e mbajtur me degën e thesarit dhe janë analitike.

Llogaria 532 paraqet vlerën e pullave të taksës gjendje në 31/12. Kjo llogari për cdo vit ka kartelën e saj analitike dhe gjendja e saj është e rakorduar me procesverbalin e mbajtur në fund të cdo viti ushtrimor edhe me degën e tatim taksave Fier.

Llogaritë 31 dhe 32 paraqesin gjendjen e materialeve në magazinë. Këto llogari kanë inventarin e tyre analitik.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Llogaria 4342 paraqet detyrimin që ka buxheti i shtetit për pagat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetsore etj të muajit dhjetor të cilat paguhen në muajin janar të vitit pasardhës. Vlera e kësaj llogaria është e barabartë me vlerat e listpagesës së kontabilizuar të muajit dhjetor të viti ushtrimor.

b) Aktivet Afatgjata

Aktivët afatgjata për periudhën e audituar në mbyllje të vitit paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Viti 2020	Viti 2019
II	Aktivët Afatgjata	39,154,269	39,938,049
	1. Aktivët Afatgjata jo materiale	0	0
	2. Aktivët Afatgjata materiale	39,154,269	39,938,049
212	Ndertime	27,263,373	25,566,223
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	2,843,957	3,539,689
215	Mjete transporti	1,000,879	1,251,099
218	Inventar ekonomik	8,046,061	9,581,037
	3. Aktivët Afatgjata Financiare	0	0
	4. Investime	0	0

Llogaria 212 paraqet vlerën e godinës së gjykatës.

Llogaria 214 paraqet vlerën e instalimeve teknike si kondicionerë, paisjeve si sistemi kamerave , fonisë etj .

Llogaria 215 paraqet vlerën e mjeteve të transportit

Llogaria 218 paraqet gjendjen në vlerë të zërave ‘’Mobilje Zyre ‘’, ‘’Paisje informative’’, Fotokopje, Printera, Server, etj. Edhe kjo llogari shoqërohet me inventarin analitik.

Aktivët afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën neto në përputhje me udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018 ‘‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme’’. ‘’

c) Pasivët (Detyrimet) dhe fondi konsoliduar

Pasivët për periudhën e audituar paraqiten si vijon:

Në lekë

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Viti 2020	Viti 2019
B	PASIVE	11,606,694	10,307,663
	LPasivët Afatshkurtra	11,606,694	10,307,663
	1. Llogari të Pagushme	11,606,694	10,307,663
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	522,641	292,919
42	Detyrime ndaj personelit	3,707,654	3,737,979
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	586,620	607,968
435	Sigurime Shoqërore	748,342	739,784
436	Sigurime Shëndetsore	161,750	164,039
437,438	Organizma të tjera shteterore	91,596	100,011
464	Det. për tu paguar për bl. letrave me vlere	1,006,000	1,012,000
466	Kreditore për mjete në ruajtje	4,782,091	3,652,963
	2. Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
	LPasivët Afatgjata	0	0
	FONDET NETO PERBEHEN NGA	40,456,613	41,285,222
101	Teprica (Fondi I akumuluar)/ Deficiti I akumuluar	40,501,444	41,880,792
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	-44,831	-595,570
X	Huate dhe Kapitali	52,063,307	51,592,886

Detyrimet janë të pasqyruara me vlerat e tyre.

Llogaria 401- 408 paraqesin detyrimet e lindura ndaj operatorëve ekonomikë në muajin dhjetor të vitit ushtrimor të mbyllur por të palikujduara e që janë shlyer në vitin ushtrimor pasardhës.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Kjo llogari është e shoqëruar me listen e operatorve ekonomikë dhe vlerat përkatëse (*Inventarin analitik*).

Llogaria 42 paraqet detyrimet ndaj punonjësve për pagat e muajit Dhjetor që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës. Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën neto të pagave sipas kontabilizimit të listpagesës së muajit dhjetor.

Llogaritë 431,435,436,438 paraqesin përkatësisht detyrimin për tatimin mbi pagat, për sigurimet shoqërore, për sigurimet shëndetsore, për sigurimin suplementar që rrjedhin nga pagat e muajit dhjetor. Vlera e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat sipas kontabilizimit të listpagesës së muajit dhjetor.

Shuma e llogarive të pagueshme të pasiveve afatshkurtëra janë të barabarta me shumën e llogarisë 4342 të paraqitur në aktiv të bilancit.

Llogaria 464 paraqet vlerën e pullave të taksës gjendje më 31/12 si detyrim ndaj degës tatim taksave Fier ndërkohë që sipas udhëzimit nr.8 datë 09/03/2018“*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme*“ në pjesën ku flitet për funksionimin e llogarisë 532 “Vlera të tjera“ shpjegohet mënyra si kontabilizohen dhe pasqyrohen lëvizjet e letrave me vlerë (në rastin konkret pullat e taksës) të cilat ose pasqyrohen në llogarin kundërparti 468, “debitorë të ndryshëm“ ose me llogarinë 630, “Ndryshimi gjendjeve“. Për mungesë të efekteve apo ndikimeve nuk e gjykojmë të trajtohet si gjetje por N.Zbatues duhet të bëjë sistemimin kontabël në llogarinë përkatëse.

Në pasiv paraqitet Fondeve Neto të cilat përbëhen nga:

Llogaria 101 paraqet vlerën e fondit të akumuluar/deficitit të akumuluar /fondet Neto.

Llogaria 85 (*rezultati i ushtrimit*) paraqitet me gjendje dhe është e barabartë vlerën e ndryshimit të gjendjeve të llogarive të kl.3(*Inventari qarkullues*).

Rezultati i vitit të mbyllur ushtrimor 2019 nuk është transferuar në fillim të vitit pasardhës 2020 tek rezultatet e mbartura por është transferuar tek llogaria 85 “rezultatit i vitit ushtrimor” jo në përputhje me udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018“*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme*“. Edhe në këtë rast vlerësojmë se nuk duhet trajtuar si gjetje por N.Zbatues duhet të beje korigjimet e nevojshme dhe ti pasqyrojë ato në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021.

1.2.Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve(Performancës Financiare)

U audituan të dhënat e pasqyrave të performancës financiare nga ku rezulton se :

Në pasqyrën e të ardhurave janë pasqyruar vlerat përkatëse të të ardhurave të përdorura gjatë vitit ushtrimor e që përbëhen nga granti i buxhetit të shtetit dhe të ardhurat në masën 10% që përfiton gjykata nga vjelja e tarifës së shërbimit gjyqësor.

Në këtë pasqyrë janë pasqyruar drejt dhe në llogaritë përkatëse të gjitha të ardhurat

-Në pasqyrën e shpenzimeve janë pasqyruar drejt sipas klasifikimit ekonomik të llogarive shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, sigurime shëndetsore si dhe shpenzimet operative të llogarisë 602.

Shpenzimet operative janë të detajuara sipas zërave dhe nënzërave dhe pasqyrojnë drejt dhe në mënyrë të saktë shpenzimet e kryera nga gjykata.

Njëkohësisht shpenzimet janë në përputhje me planifikimin e bërë në fillim të vitit dhe ndryshimet përkatëse që ka pësuar gjatë vitit.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Për regjistrimet e shpenzimeve është respektuar parimi i konstatimit dhe si rrjedhojë janë pasqyruar edhe shpenzimet e papaguara të muajit dhjetor.

Rezultati i ushtrimit tek pasqyra e pozicionit financiar është e barabartë me tepricën e vitit ushtrimor të pasqyrës së pozicionit financiar.

U auditua pasqyra e fluksit të parave (Cash flow) në të cilën vlerat janë pasqyruar drejt dhe teprica e likujditeteve është e barabartë me gjendjen e mjeteve monetare të pasqyrës së pozicionit financiar.

Në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto janë pasqyruar postet me vlerat përkatëse që përbëjnë fondet neto dhe vlera e tyre përputhet me vlerën e tyre në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në pasqyrën e investimeve dhe burimet e financimit të tyre janë paraqitur shpenzimet për investimet e realizuara dhe burimet e financimit si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta njëkohësisht edhe dhurimet në natyrë.

Në pasqyrat e gjendjes dhe ndryshimit të AAGJ me kosto historike dhe vlerë neto janë pasqyruar ndyshimet e ndodhura në shtimin dhe pakësimin e tyre dhe rakordojnë me pasqyrën e pozicionit financiar.

Njëkohësisht pasqyrat financiar shoqërohen me pasqyrën statistikore të nr.punonjësve të detajuar dhe fondit të pagave e sigurimeve shoqerore shëndetsore.

Pasqyrat financiare janë shoqëruar me relacionin shpjegues të posteve dhe vlerave të tyre sipas formatit të miratuar.

Opinion i përgjithshëm: Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e raportimit financiar publik ka funksionuar, por ka nevojë për tu përmirësuar.

4.6. Sistemi i prokurimeve me vlerë të lartë dhe vlerë të vogël

Auditimi i përputhshmërisë ligjore në lidhje me procedurat e prokurimit, u përqendrua kryesisht në segmente të tenderimit, konkretisht : në vlerën e prokurimit të parashikuar në RPPP (*fondin limit të përgjithshëm*), krahasuar me vlerën e prokuruar (*fondin limit të llogaritur*) dhe vlerën e realizuar (*vlerën e kontratës*); në hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit; në përcaktimin dhe argumentimin e kritereve të kualifikimit; në hartimin e dokumentave të tenderit; në përzgjedhjen e fituesit; në lidhjen dhe zbatimin e kontratës nga ofertuesi i shpallur fitues.

Autoriteti Kontraktore, referuar VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 2..... “Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të **punësojë ekspertë të jashtëm**” dhe Ligjit Nr.7961, date 12.07.1995, “Kodi i Punes i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, ka lidhur kontrate punes individuale, me kohe të pjesshme nr.prot.405, date 23.01.2020 për : Sherbimin e konsulences juridike me një Jurist jashtë strukture të gjykatës. Për të kryer detyrën si: Konsulent ligjor për prokurimet publike; Anetar i komisionit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël; Anetar i njësive të prokurimit për procedurat e prokurimit me vlerë të lartë; Personi përgjegjës për prokurimet dhe si person përgjegjës për menaxhimin e sistemit të prokurimeve elektronik(SPE) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Titulli i Gjetjes 2: Punësimi i juristit të jashtëm me kohe të pjesshme është bërë pa miratim të organit qendror/KLGJ-se (organi që miraton fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për funksionimin e gjykatës). Shuma e paguar në vlerën 17000 leke/muaj(20000-3000 tatami në burim), nuk është parashikuar/miratuar në buxhetin e gjykatës për vitin 2020.

Referuar VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 1. Kryetarja e

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Autoritetit Kontraktor, me urdherin nr.107, date 11.02.2019 dhe nr. prot 25, date 16.01.2020, ka percaktuar personin pergjegjes te prokurimit, perkatesisht per vitin 2019 dhe 2020.

Per vitin 2020, si person pergjegjes per procedurat e prokurimit me vlere te larte dhe procedurat e prokurimit me vlere te vogel, eshte caktuar një Jurist jashte strukture të gjykatës. Referuar VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3 “Personi/at pergjegjes per prokurimin kryen/jne detyrat”:*nuk rezulton ne asnje nen/pike/paragraf dhe eshte e pa mundur administrativisht/teknikisht që personi i punesuar me kohe te pjesshme dhe perkohesisht te kryej detyrat e personit pergjegjes per prokurimin ne Autoritetin Kontraktor “Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier”.*

Ne organike te gjykates ka Jurist dhe specialist te fushave te ndryshme, si: Ekonomist, Inxhinjer etj., per tu caktuar si person/a pergjegjes per prokurimin apo si anetare te komisionit per prokurimet me vlere te vogel, të cilët janë prezent çdo ditë në punë(*duhen trajnuar/kualifikuar, merret asistence nga APP, gjetje dhe rekomandim i lënë në auditimin e mëparshëm*).

Autoriteti Kontraktor gjate gjithë vitit 2020 ka realizuar vetem 1(një) procedure prokurimi me vlere te larte. Juristi jashte strukture te gjykates/eksperti i jashtem duhet te merrej si konsulent ligjor, anetar i njesise se prokurimit vetem per proceduren e prokurimit me vlere te larte “Kerkese per Propozim”- Pune, me objekt “Rikonstruksioni i rjetit elektrik ekzistues”. Ne nje procesverbal te vecante, anetaret e njesise te prokurimit caktojne njerin nga anetaret si person i autorizuar per te kryer veprimet ne SPE(Sistemin e Prokurimeve Elektronike), per proceduren e prokurimit.

Në fillim të viti kalendarik nga Kryetari i autoritetit kontraktor me Urdherin Nr.11, date 09.01.2019 dhe Nr.prot. 27 date 16.01.2020, eshte krijuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, që ka funksionuar gjatë gjithë vitit 2019 dhe 2020. Për vitin 2020 ne perberje te komisionit te prokurimit me vlere te vogel eshte caktuar dhe Juristi jashte strukture te gjykates - personi pergjegjes per prokurimin. Referuar akteve ligjore dhe nenligjore në fushën e prokurimeve.....*nuk rezulton ne asnje nen/pike/paragraf dhe eshte e pa mundur administrativisht/teknikisht që personi i punesuar me kohe te pjesshme dhe perkohesisht te kryej te gjitha detyrat/hapat e nje procedure prokurimi me vlere te vogel, sipas kerkesave ligjore.*

Rekomandimi Nr.2: Ne varesi te numrit te procedurave te prokurimit me vlerë të lartë te parashikuara per tu zhvilluar gjate vitit nga Autoriteti Kontraktor, te kerkohet ne organin qendror/KLGJ, miratim per: Punesimin e Juristit jashte strukture te gjykates, me kontrate pune te perkoheshme/pjesshme(*si ekspert i jashtem per procedurat e prokurimit me vlere te larte*); Percaktimin e menyres/mases te pageses(*me page orare ose sipas numrit te procedurave te prokurimit te parshikuara nga AK per t’u zhvilluar gjate vitit apo vleres prokurimit te parashikuar*); Fondin e nevojshem per pagesen ekspertit te jashtem/mbulimin e shpenzimit/burimi i financimit. Si person pergjegjes per prokurimin te caktohet nje person brenda strukture te gjykates. Ne perberje te komisionit te prokurimit me vlere te vogel te jene punonjes brenda strukture te gjykates(*të jenë prezent çdo ditë në punë, me kohe te plote*). Te merren masa te menjehereshme per kualifikimin e punonjesve qe do te angazhohen ne procedurat e prokurimit qe do te zhvilloje autoriteti kontraktor ne vazhdim, duke mos perjashtuar marrjen e asistences nga APP-ja, për te siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale/administrative.

Në bazë të kërkesave për punë, mallra dhe shërbime, komisioni i ngritur per kete qellim, ka hartuar regjistrin vjetor të parashikimit për procedurat e prokurimit publik(RPPP), miratuar ne mbledhjen e GMS te dates 23.01.2020. Një kopje e RPPP pasi eshte publikuar ne faqen zyrtare te APP-se, me

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

shkresen Nr.prot. 10/1, date 10.01.2019, Nr.prot.3559, date 25.04.2019, Nr.43, date 24.05.2019, Nr.prot.3978, date 01.07.2020, Nr.4884, date 01.09.2020, Nr.prot.6272, date 26.10.2020, Nr.7244, date 02.12.2020 është dërguar në Degën e Thesarit, dhe me shkresen Nr.prot. 729, date 30.01.2019, Nr.prot.535,date 27.01.2020, në organin qendror/KLGJ që ka vënë në dispozicion fondet buxhetore. Autoriteti kontraktor gjatë vitit në raste të justifikuara ka bërë ndryshime në RPPP. Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit ne faqen zyrtare te APP-se është dërguar në Degën e Thesarit dhe në organin qendror/KLGJ që ka vënë në dispozicion fondet buxhetore.

- Sipas RPPP dhe RRPP, Autoriteti Kontraktor, per vitin 2019 ka parashikuar te zhvilloje 1(një) procedurë prokurimi me vlere te larte, “Kerkese per Propozim”- Marreveshje kuader, me objekt prokurimi “Sherbime te ruajtjes dhe sigurimit te godines”, ne vleren 2 367 000 leke pa tvsh. Realizuar ne muajin shtator, me vlere kontrate te lidhur 2 253 599 leke pa tvsh dhe 2 704 319 leke me tvsh.

- Sipas RPPP dhe RRPP, Autoriteti Kontraktor, per vitin 2020 ka parashikuar te zhvilloje ne muajin shtator 1(një) procedurë prokurimi me vlere te larte, “Kerkese per Propozim”, me objekt prokurimi “Rikonstruksion i rrjetit elektrik” - Pune, ne vleren 2 416 667 leke pa tvsh dhe 2 900 000 leke me tvsh. Realizuar ne muajin shtator, me vlere kontrate te lidhur 2 289 500 leke pa tvsh dhe 2 747 400 leke me tvsh.

Gjatë periudhës objekt auditimi, autoriteti kontraktor ka realizuar 2(dy) procedura prokurimi me vlerë të lartë në SPE, nga keto u auditua 1(nje), konkretisht :

Nr	Viti	Objekti i prokurimit	Vlera në lekë e prokuruar me tvsh	Vlera në lekë e fituar me tvsh	Diferenca +/-	Llojë i procedurës
1	2020	Rikonstruksion i rrjetit elektrik	2 878 260	2 747 400	- 130 860	Kërkesë për propozim
Totali			2 878 260	2 747 400	- 130 860	

Nga analiza e procedurës te prokurimit me vlerë të lartë të realizuar nga autoriteti kontraktor dhe të audituar rezulton se: **Fondi limit i pergjithshem** i parashikuar ne RPPP ne fillim te vitit (2 900 000 leke me tvsh), krahasuar me vleren e prokuruar/**fondin limit te llogaritur** (2 878 260 lekë me tvsh)), është po thuajëse e njëjtë, me pak - 21 740 leke(2 900 000 - 2 878 260), krahasuar me vlerën e realizuar/**vlera e fituar/kontratës**, me nje diference - 130 860 leke (2 878 260 - 2 747 400), që tregon mungese pjesmarrje dhe konkurrence midis operatoreve ekonomik pjesmarres.

Për tenderin e audituar, ne perfundim te auditimit dhe ballafaqimeve gjendja paraqitet si me poshte:

1. Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt prokurimi “**Rikonstruksion i rrjetit ekzistues elektrik**”, realizuar ne vitin 2020 me procedurën e prokurimit “Kerkese per Propozim” - Pune, me pjesmarrje ne konkurim te 2(dy) OE te kualifikuar, pa ankesa per dokumentat e tenderit dhe per vleresimin dhe klasifikimin e ofertave dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësta e prokurimit
A	B	C

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

<p>1.Urdhër Prokurimi Nr.14 Datë 01.09.2020. 2.Fondi limit - pa tvsh 2 398 550 leke. - me tvsh 2 878 260 leke. 3.Pr.Prok.“Kerkese per Propozim” - Pune. 4.Data e zhvillimit te tenderit 14.09.2020. 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fitues: “Colombo” shpk. 7. Data e lidhjes te kontratës: 22.10.2020. 8. Vlera e kontratës : - pa tvsh 2 289 500 leke. - me tvsh 2 747 400 leke. 9.Difer.mes f.limit e kont.130 860 lekë me tvsh. 10.Lik.kont. 2 609 859 leke(pa 5% garancia punimeve ne vleren 137 541 leke).</p>	<p>1.Armela Divija, Kryetare 2.Tabene Senkaj, Anetare 3.Valentina Seci, Anetare</p>	<p>1.Andi Grykshi, Personi pergj.prok. 2.Mimoza Petushi, Anetare 3.Majlinda Ferro, Anetare</p>
--	---	--

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës

Autoriteti Kontraktor ne RPPP, te vitit 2020 i ndryshuar, ka parashikuar per te zhvilluar proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim” - Pune, me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ekzistues elektrik”, ne vleren 2 416 667 leke pa tvsh dhe 2 900 000 leke me tvsh, ne muajin shtator.

Me urdherin e Kryetares te AK nr.prot.4823 datë 01.09.2020 eshte ngritur komisioni per hartimin e specifikimeve teknike, perlogaritjen e fondit limit dhe grafikun e zbatimit te punimeve. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiper komisioni i ngritur per kete qellim, bazuar ne projektin, relacionin teknik, grafikun dhe preventivin e punimeve te hartuar nga studio e projektimit “Solar Energy Solutions” sh.p.k, shpallur fitues ne proceduren e prokurimit me objekt “Hartimin e projektit per rikonstruksionin e rrjetit ekzistues elektrik”, realizuar ne daten 13.07.2020, ka dokumentuar ne procesverbalin nr.1,nr.prot.4823/1, date 01.09.2020, fondin limit ne vleren 2 398 550 leke pa tvsh dhe 2 878 260 leke me tvsh(- 18 117 leke pa tvsh, me pak se sa fondi limit i pergjithshem i parashikuar ne RPPP, te ndryshuar).

II.Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Njesia e Prokurimit e ngritur në Urdhër Prokurim nr.14, datë 01.09.2020, ne kete te fundit eshte përcaktura që procedura e prokurimit do të jetë “Kerkese per Propozim”- Pune, me fond limit 2 398 550 leke pa tvsh.

Ne daten 01.09.2020 anetaret e njesise te prokurimit kane plotesuar Formularin e Deklarimit te konfliktit te interest. Ne mbeshtetje te nenit 61 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, jane hartuar dhe argumentuar dokumentat e tenderit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit), dokumentuar ne procesverbalin nr.2,nr.prot.4823/3 date 01.09.2020.

Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithë anetaret e NjP, në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ,i ndryshuar dhe VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne SPE ka hedhur Dokumentat e Tenderit bashke me Formularin e Njoftimit te Kontrates me nr.prot.4823/4 date 01.09.2020, si dhe janë ftuar 5 OE, te perzgjedhur me pare nga NjP, dokumentuar ne procesverbalin nr.2, nr.prot.4823/3 date 01.09.2020 “Rikonstruksioni i rrjetit ekzistues elektrik”. NjP nuk ka argumentuar procesin e perzgjedhjes te operatoreve ekonomik, arsyet qe kane çuar drejt operatoreve te ftuar ne proceduren e

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

prokurimit te zhvilluar nga autoriteti kontraktor. Veprime dhe mosveprime keto jo ne perputhje me kerkesat e VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, neni 39, pika 4, ku cilesohet... “Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës.....,autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. **Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë**”..... (ne procesverbal evidentohen vetem operatoret ekonomik qe do te ftohen, pa argumenta).

Dokumentat e tenderit dhe Njoftimi i Kontrates me nr.prot.4823/4 date 01.09.2020 jane Publikuar ne faqen e APP-se , ne daten 02.09.2020 dhe ne Buletinin e APP-se Nr.66, date 08.09.2020.

Rezulton se ne Njesine e Prokurimit nuk eshte perfshire/marre **nje specialist fushe** (inxhinjer elektrik). Ne perberje te Njesise te prokurimit te ngritur/krijuar me urdher te Kryetares te AK është personi pergjegjes per prokurimin, eksperti i jashtem per prokurimet me vlere te larte dhe vlere te vogel, me profesion Jurist, Kryetarja e Deges Buxhetit, me profesion, Ekonomist dhe nje sekretare gjyqesore, me profesion Jurist. Procedura e prokurimit ka si objekt “Rikonstruksionin e rrjetit ekzistues elektrik”. Referuar projektit, relacionit teknik, preventivit te punimeve te hartuar nga studio e projektimit “Solar Energy Solutions” sh.p.k, konstatohet se: ka punime/pajisje elektrike per rrjedhoje specialistia e IT-se, si anetare e komisionit per hartimin e specifikimeve teknike dhe perllogaritja e fondit limit nuk ka kualifikimet e mjaftueshme/nevojshme ne fushen elektrike, per **Hartimin e kriterëve të veçanta të pranimit**. Gjithashtu mos perfshirja/marrja e **nje specialisti fushe** (inxhinjer elektrik) ne njesine e prokurimit, nuk eshte ne perputhje me kerkesat e VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, neni ,57 pika 2 dhe 4.

Titulli i Gjetjes 2: Njesia e Prokurimit ka vendosur kriteret jo në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik:

Nr.gjetjes 3	
Subjekti audituar	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier • Këshilli i Lartë Gjyqësor
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr.9643,datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 20 dhe 46. VKM-ja Nr.914,date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 26, 57 dhe 61.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Ne kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar:</p> <p>2.3 Për kapacitetin teknik:</p> <p>2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën individuale të punës të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhen Janar 2020 - Korrik 2020, stafin inxhinierik si më poshtë: 2 (dy) Inxhinier Elektrik ku njeri duhet te jete me certifikim <u>AUDITUES ENERGJIE.</u> 1 (nje) Inxhinier Mjedisi (me <u>certifikate Auditimi Mjedisor/ekspert mjedisor</u>, certifikuar per demet ne mjedis).</p> <p>2.3.4 Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij <u>1 (nje) mjek</u> nisur edhe nga situata e pandemise qe po kalojme. Per te vertetuar kete</p>

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

	<p>kriter duhet te paraqitet kontratë individuale të punës të vlefshme, license profesionale (urdher mjeku) dhe diploma perkatese. Mjeku duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise për periudhen Janar 2020 - Korrik 2020.</p> <p>2.3.5 Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist <u>Ekspert Zjarrfikes</u> ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2020 - Korrik 2020. Detyrimisht te paraqitet kontrate individuale të punës të vlefshme dhe certifikata perkatese.</p> <p>Kriteri: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne menyre qe te rritet pjesmarrja, sigurimi i konkurences midis operatoreve ekonomik pjesmarres dhe barazia ne tender, per te stimuluar dhe biznesin e vogel dhe te mesem.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ne pjesmarrjen e operatoreve ekonomik ne konkurim(kane marre pjese vetem dy operatore ekonomik); ne konkurencen midis operatoreve ekonomik pjesmarres(diferenca e fondit limit te llogaritur me vleren e kontrates te lidhur eshte minimale).</p> <p>Shkaku: Mos perfshirja/marrja e nje specialisti te fushes (inxhinjer elektrik) ne njesine e prokurimit, per hartimin e kriterëve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik dhe përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit.</p>
<p>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</p>	<p>Risk i mesem</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>Në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor në përbërjen e njesise te prokurimit, cakton dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit do te hartoi specifikimet teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera. Përlllogaris fondin limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme. Te hartoi kriteret e veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik. Te hartoi kriteret e vlerësimit, nëse është rasti dhe te përcaktoi çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit.</p>
<p>Rekomandimi nr.3</p>	<p>Njësia e Prokurimit të tregojë më shumë kujdes në përcaktimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Ne menyre qe te rritet pjesmarrja, sigurimi i konkurences midis operatoreve ekonomik pjesmarres dhe barazia ne tender.</p>

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vijimësi nga autoriteti kontraktor.
Statusi i rekomandimit	

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin e K/AK nr.14/1 date 01.09.2020 është ngritur KVO-ja. Sipas njoftimit të kontrates të publikuar në Buletinin e APP-se, personi i autorizuar ka mbyllur në SPE fazën e dorëzimit të ofertave në oren dhe datën e publikuar.

Sipas procesverbalit të datës 14.09.2020 për “Hapjen e procedurës së prokurimit”, rezultoi të kenë marrë pjesë në konkurim 2(dy) operatore ekonomik:

1. “Colombo” shpk
2. “Ergi” shpk

Sipas procesverbalit të datës 24.09.2020 për “Vlerësimin e ofertave”, rezultoi të jenë kualifikuar nga KVO-ja të 2(dy) OE pjesëmarrës.

1. “Colombo” shpk, me vlerë oferte 2 289 500 leke pa tvsh.
2. “Ergi” shpk, me vlerë oferte 2 371 250 leke pa tvsh.

Klasifikimi perfundimtar në SPE është bërë në datën 24.09.2020, konkretisht :

Në vendin e parë, “Colombo” shpk, me vlerë oferte 2 289 500 leke pa tvsh.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afatit të ankimimit në datën 02.10.2020 ka përgatitur raportin përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe i ka propozuar titullarit të autoritetit kontraktor, të shpall fitues “Colombo” shpk, me vlerë oferte 2 289 500 leke pa tvsh. Miratuar nga Kryetarja e AK me vendimin Nr.prot.4823/13, datë 02.10.2020.

Është plotësuar dhe dërguar/hedhur në SPE Formulari i Njoftimit të Fituesit Nr.4823/14, datë 05.10.2020, publikuar në Buletinin e APP-se nr.85, datë 12.10.2020.

Për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave nuk ka pasur ankesa.

VI.Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në procedurën e prokurimit.

Perpara se të lidhet kontrata, nga KVO-ja është bërë vlerësimi i dokumentave fizik, dorëzuar në mënyrë shkresore nga Operatori Ekonomik i shpallur fitues, dokumentuar në procesverbalin e datës 22.10.2020. Nga krahasimi i dokumentave të hedhur në sistemin elektronik me dokumentat e dorëzuara në mënyrë shkresore nuk rezultuan ndryshime.

Sipas formularit të sigurimit të kontrates, sigurimi i kesaj të fundit është bërë në datën 19.10.2020, në vlerën 274 740 leke ose 10% të vlerës totale të kontrates.

Mbas sigurimit të kontrates dhe marrjes në dorëzim të dokumentave fizik, me OE “Colombo” shpk, është lidhur Kontrata nr.prot.4823/17 datën 22.10.2020 në vlerën 2 289 500 leke pa tvsh dhe 2 747 400 leke me tvsh.

Formulari i Publikimit të Njoftimit të Kontrates së Nenshkruar nr.prot.4823/19, datë 26.10.2020 është publikuar në Buletinin e APP-se Nr.94 datë 02.11.2020.

Perveç dosjes të procedurës të prokurimit, grupit të auditimit ju vu në dispozicion dhe dosja tekniko – ligjore, hartuar nga Mbikqyresit i punimeve “M.C.E” shpk, në mbështetje të Ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM-se Nr.3, datë 15.02.2001 dhe VKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, si dhe Udhezimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Nga verifikimi rezultoi se dosja teknike është e rregullt, i gjithë dokumentacioni vlerësohet i rregullt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Me Ush. Nr.289, datë 28.12.2020 është likuiduar “Colombo” shpk, në vlerën 2 609 859 leke(2 747 220 - 137 361/5% garancia e punimeve) për rikostruksionin e rrjetit elektrik, është mbajtur garancia e

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

punimeve , ne masen 5% dhe ne vlere absolute 137 361 leke. Sipas fatures tatimore nr.74, date 02.12.2020 te firmosur nga komisioni i marrjes ne dorezim dhe situacionit te punimeve date 25.11.2020 ne vleren 2 289 350 leke pa tvsh dhe 2 747 220 leke me tvsh, firmosur nga kryetari i autoritetit kontraktor, sipermarresi i punimeve dhe mbikqyresi i punimeve. Akt - kolaudimi date 02.12.2020, nenshkruar nga Investitori, Sipermarresi i punimeve, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori. Nga AK nuk eshte ngritur komisioni per marrjen ne dorezim te rikonstruksionit te rrjetit elektrik. Ne aktin e marrjes ne dorezim kane firmosur anetaret e komisionit te marrjes ne dorezim te aktiveve te ngritur ne fillim te vitit nga Titullari, ne perberje te se cilit ne emertese/strukture jane sekretare gjyqesore dhe mirembajtes.

Sipas Liste inventari te dates 31.12.2020, dosja fizike e tenderit eshte sistemuar, inventarizuar, nuk eshte protokolluar dhe dorezuar ne arkiven e gjykates (pa nr.prot. pa nenshkrimin e arkivistes ne listen e inventarit, pa procesverbal dorezimi ne arkive. Veprime dhe mosveprime keto jo ne perputhje me Udhëzimin “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.....(gjetje dhe rekomandim i lene ne auditimin e meparshem).

4.6.1. Auditimi për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Në mbështetje të nenit 29, pika 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Neni 40, pika 3, Kreu IV të VKM-së nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pikës 2 te Udhëzimit Nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Në fillim të vitit nga Kryetarja e autoritetit kontraktor eshte krijuar komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2019, me Urdherin Nr.prot.11, date 09.01.2019 dhe për vitin 2020, me Urdherin Nr.prot.27, date 16.01.2020.

Autoriteti Kontraktor per periudhen objekt auditimi, ka realizuar 47 procedura, nga keto: 19 procedura prokurimi me vlere te vogel, realizuar në SPE dhe 28 procedura te realizuara ne menyre shkresore.

Për vitin 2019, janë realizuar 22 procedura, nga keto: 11 procedura prokurimi të realizuara në SPE dhe 11 procedura te realizuara ne menyre shkresore.

Për vitin 2020, janë realizuar 25 procedura, nga keto: 8 procedura prokurimi të realizuara në SPE dhe 17 procedura te realizuara ne menyre shkresore.

Për periudhën objekt auditimi, u audituan gjithsej 32 procedura prokurimi me vlerë të vogël, nga këto: 8 procedura prokurimi te realizuara në SPE dhe 24 procedura blerje me vlere te vogel, te realizuara në mënyrë shkresore.

- Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nga 100 000 - 800 000 lekë pa tvsh, realizuar në SPE dhe audituar :

Nr	Objekti i shpenzimit	Urdher shpenzimi		Shuma ne leke
		Nr	Data	
1	Blerje leter A4	83	08.05.2020	297 960
2	Blerje kancelari	115	13.08.2020	363 552
3	Blerje serveri	227	21.10.2020	942 000
4	Sherbim printimi	240	11.11.2020	286 502
5	Blerje shtypshkrime	277	14.12.2020	108 600
6	Blerje poltrona rrotullues	285	15.12.2020	168 000

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

7	Mirembajte pajisje fotokopje	287	22.12.2020	172 800
8	Blerje kancelari	285	25.11.2019	201 240

- Blerjet e vogla me vlere deri 100 000 leke pa tvsh, te realizuara në menyre shkresore dhe te audituara:

Nr	Objekti i shpenzimit	Urdher shpenzimi		Shuma ne leke
		Nr	Data	
1	Blerje pjese kembimi	248	19.05.2020	20 020
2	Sherbim interneti	95	15.06.2020	8 200
3	Blerje materiale dezifektimi	98	15.06.2020	119 000
4	Blerje Tонера	125	22.06.2020	119 400
5	Siguracion makine	147	03.08.2020	36 637
6	Blerje materiale rutine	156	13.08.2020	116 700
7	Blerje pjese kembimi	157	13.08.2020	23 903
8	Blerje rafte arshive	158	13.08.2020	98 548
9	Projekti i rrjetit elektrik	159	13.08.2020	118 800
10	Projekti per MKZ	228	21.10.2020	119 400
11	Blerje materiale pastrimi	229	21.10.2020	120 000
12	Mirembajtje kondicioneri	230	21.10.2020	69 600
13	Mirembajtje e pajisjeve kunder zjarrit	241	11.11.2020	120 000
14	Blerje materiale dezinfektimi	264	24.11.2020	86 580
15	Projekt i dhomes serverit	276	14.12.2020	120 000
16	Blerje veshje gjyqtari	288	24.12.2020	117 600
17	Mirembajtje te rrjetit elektrik	290	28.12.2020	96 000
18	Kolaudimi i punimeve per rrjetin elektrik	291	28.12.2020	13 440
19	Blerje materiale pastrimi	247	22.10.2019	110 340
20	Blerje tonera	248	22.10.2019	49 998
21	Mirembajtje pajisje kundra zjarrit	249	22.10.2019	64 800
22	Mirembajtje sistemit te sigurise	283	25.11.2019	118 200
23	Blerje pajisje te sistemit te sigurise	284	25.11.2019	117 000
24	Mirembajtje gjeneratori	251	22.10.2019	26000

Nga verifikimi në sistemin elektronik dhe dokumentacionit përkatës, rezulton se: AK ka vepruar në përputhje me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nenin 40 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Udhëzimin Nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Manualin Teknik “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.

Përveç sa u trajtua me larte për procedurat e prokurimit me vlere te vogel të realizuara nga Autoriteti Kontraktor dhe të audituara, për periudhën objekt auditimi, u konstatua si parregullsi :

Titulli i Gjetjes: Nuk janë argumentuar dhe dokumentuar në një procesverbal të veçantë, specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, të përfshira ne FO. Nuk është dorezuar ne zyren e protokollit dokumentacioni i kerkuar ne Ftesen për oferte, nga operatori ekonomik i shpallur fitues:

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Nr.gjetjes 4	
Subjekti audituar	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier • Këshilli i Lartë Gjyqësor
Përmbledhja e bazës ligjore	<p>Neni 23 i Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.</p> <p>Neni 26, 27, 28, 40 dhe 61 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi i APP-se Nr.6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit”, pika II.1.a.b.c.</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: - Në 6(gjashtë) raste nuk janë <i>argumentuar dhe dokumentuar</i> ne nje procesverbal te veçante specifikimet teknike dhe kerkesat per kualifikim, per mallin/sherbimin/punen objekt prokurimi.</p> <p>- Ne te gjitha rastet dokumentacioni i kerkuar ne permbushje te kerkesave te percaktuara ne Ftesen per Ofertë, nuk eshte dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit.</p> <p>Kriteri: - Në çdo rast, hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, specifikimet teknike dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht dhe dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre/komisioni i prokurimit me vlere te vogel.</p> <p>- Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të percaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Veshtiresi tek operatoret ekonomik ne hartimin e ofertes ekonomike. Rritja e shpenzimeve procedurale si rezultat i pjesmarrjes ne konkurim te operatoreve ekonomik te pa pergjegjshem.</p> <p>Shkaku: Mos përditësimi ne kohe me ndryshimet ligjore dhe nenligjore ne fushen e prokurimeve publike. Mos kualifikimi i punonjesve te perfshire ne procedurat e prokurimit te zhvilluara nga autoriteti kontraktor.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm
Konkluzioni	Faza e hartimit te specifikimeve teknike/termave te references dhe vendosja e kriterëve per kualifikim nuk eshte vlerësuar sa duhet nga komisionet e ngritura per kete qellim.
Rekomandimi nr.4	- Përpara se te dale Urdher prokurimi nga Kryetari i AK, komisioni i prokurimit me vlere te vogel te siguroje ose hartoje specifikimet teknike/termat e references per mallrat ose sherbimet qe do te prokurohen. Ne baze te se cilave te llogaritet dhe fondi limit.

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

	<p>- Në raste specifike, komisioni në varësi të llojit të objektit të prokurimit, të kërkojë plotësimin e një ose disa kritereve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues, duke mos i ekzagjeruar dhe te kene lidhje me objektin e prokurimit.</p> <p>Te gjitha veprimet e mesiperme te dokumentohen ne nje procesverbal te veçante nga komisioni i prokurimit me vlere te vogel.</p> <p>- Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor.</p>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël që do të zhvillohen në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	

Opinion i përgjithshëm : Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimeve ka funksionuar, por ka nevojë për tu përmirësuar.

Projekt raport auditimi mbahet në dy kopje.

Grupi i Auditimit

Agim Koçi

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier

Zv/Kryetare e Gjykatës

Matilda Shalla

Aneksi 1

PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

PËR GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Nr.	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1	Regjistrimet në librat kontabël, të dokumentacionit të blerjeve, të kryhet duke evidentuar me vërtetësi ngjarjen ekonomike të ndodhur (<i>blerjen e aktiveve apo shërbimit</i>) dhe hyrja e aktiveve duhet të shoqërohet me Flet-Hyrjen e regjistruar në kontabilitet.	I mesëm
2	Ne varesi te numrit te procedurave te prokurimit me vlerë të lartë te parashikuara per tu zhvilluar gjate vitit nga Autoriteti Kontraktor, te kerkohet ne organin qendror/KLGJ, miratim per: Punesimin e Juristit jashte struktures te gjykates, me kontrate pune te perkoheshme/pjesshme (<i>si ekspert i jashtem per procedurat e prokurimit me vlere te larte</i>); Percaktimin e menyres/mases te pageses (<i>me page orare ose sipas numrit te procedurave te prokurimit te parshikuara nga AK per t'u zhvilluar gjate vitit apo vleres prokurimit te parashikuar</i>); Fondin e nevojshem per pagesen ekspertit te jashtem/mbulimin e shpenzimit/burimi i financimit. Si person pergjegjes per prokurimin te caktohet nje person brenda struktures te gjykates. Ne perberje te komisionit te prokurimit me vlere te vogel te jene punonjes brenda struktures te gjykates (<i>të jenë prezent çdo ditë në punë, me kohe te plote</i>). Te merren masa te menjehereshme per kualifikimin e punonjesve qe do te angazhohen ne procedurat e prokurimit qe do te zhvilloje autoriteti kontraktor ne vazhdim, duke mos perjashtuar marrjen e asistences nga APP-ja, për te siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale/administrative.	I mesëm
3	Njësia e Prokurimit të tregojë më shumë kujdes në përcaktimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Ne menyre qe te rritet pjesmarrja, sigurimi i konkureses midis operatoreve ekonomik pjesmarres dhe barazia ne tender.	I mesëm
4	- Përpara se te dale Urdher prokurimi nga Kryetari i AK, komisioni i prokurimit me vlere te vogel te siguroje ose hartoje specifikimet teknike/termat e references per mallrat ose sherbimet qe do te	I mesëm

<p>prokurohen. Ne baze te se cilave te llogaritet dhe fondi limit.</p> <p>- Në raste specifike, komisioni në varësi të llojit të objektit të prokurimit, të kërkojë plotësimin e një ose disa kriterëve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues, duke mos i ekzagjeruar dhe te kene lidhje me objektin e prokurimit.</p> <p>Te gjitha veprimet e mesiperme te dokumentohen ne nje proçesverbal te veçante nga komisioni i prokurimit me vlere te vogel.</p> <p>- Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor.</p>	
--	--

Grupi i Auditimit

Agim Koçi

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj

